

This project was financed by:

**Packard Humanities Institute**


and



Swedish International Development  
Cooperation Agency



address: CHwB Kosovo Office, Zogovic Str. No.8,  
Qyteza Pejton 10000 Prishtina, Kosovo  
phone: +381 38 243 918  
fax: +381 38 243 918  
e-mail: kosovo@chwb.org  
www: www.chwb.org, ww.chwb.org/kosovo



CHwB Kosovo Office  
Report series No. 10/2007

**Heritage After War**  
**The Hadum  
Mosque Restoration**

Edited by:  
Andrew Herscher

**Trashëgimia pas luftës**  
**Restaurimi i  
Xhamisë së Hadumit**

Redaktuar nga:  
Andrew Herscher

- THE HADUM MOSQUE RESTORATION - RESTAURIMI I XHAMISË SË HADUMIT -

CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
KULTURAV LITAN GRÄNSER

- THE HADUM MOSQUE RESTORATION - RESTAURIMI I XHAMISË SË HADUMIT -


**HERITAGE AFTER WAR**  
**The Hadum Mosque**  
**Restoration**

---

**TRASHËGIMIA PAS LUFTËS**  
**Restaurimi i Xhamisë së**  
**Hadumit**

CHwB Kosovo Office  
Report Series No. 10/2007





*Restored dome of the Hadum Mosque*  
*Kupolla e restauruar e Xhamisë së Hadumit*

## CONTENTS

<b>FOREWORD</b> , <i>Arch. Dick Sandberg</i>	7
<b>HERITAGE IN THE AFTERWAR</b> , <i>Dr. Andrew Herscher</i>	
Introduction	9
Heritage in War	9
Heritage in the Afterwar	11
Impossibility of Restoration	13
<b>CONTEXT OF HADUM MOSQUE IN OTTOMAN /BALKAN ARCHITECTURE</b> , <i>Prof. Dr. Zeynep Ahubay</i>	
Ottoman architecture: its architectural vocabulary and representation in the Balkans	15
Ottoman mosques-variety and symbolism	17
Hadum Mosque - its architecture and special features	21
Nineteenth century repairs and decoration - addition of double arcades - some significant details	23
<b>HADUM MOSQUE - HISTORY, ARCHITECTURE, PAINTING AND STONWORK</b> , <i>Dr. Fejz Drançolli</i>	
The architecture of Hadum Mosque	27
The Prayer Hall	27
Mihrab and Mimbër	29
Mahfil - Gallery	29
Constructive elements - pendentives	31
The Portico	33
The Portico Arcades	33
The Minaret	35
Mural decorations - arabesques	35
Stonework	38
<b>THE CHwB PROJECT 2004 - 2005</b>	
The Documentation phase	41
Description of building materials	41
Description of damages	48
<b>THE IMPLEMENTATION PHASE</b>	
The Minaret	57
The Dome	62
Portico	64
Windows and door frames	67
The Façades	71
Protection against humidity	74
The Yard	75
Conservation materials used	87
<b>OTHER VOICES ABOUT HADUM MOSQUE RESTORATION</b>	88
<b>AFTERWORD</b> , <i>Arch. Dick Sandberg</i>	94
<b>LIST OF REFERENCES</b>	96

## PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE</b> , <i>Ark. Dick Sandberg</i>	7
<b>TRASHËGIMIA PAS LUFTËS</b> , <i>Dr. Andrew Herscher</i>	
Hyrje	9
Trashëgimia në luftë	9
Trashëgimia pas luftës	11
Pamundësia e restaurimit	14
<b>KONTEKSTI I XHAMISË SË HADUMIT NË ARKITEKTURËN OSMANE DHE TË BALLKANIT</b> , <i>Prof. Dr. Zeynep Ahubay</i>	
Arkitektura osmane: artikulli arkitektonik dhe Xhamitë osmane - shumëllojshmëria dhe simbolizmi	17
Xhamia e Hadumit - karakteristikat arkitektonike dhe të veçanta	21
Riparimet dhe dekorimet e shekullit të XIX - shtimi i arkadave të dyfishta - disa detaje të rëndësishme	23
<b>XHAMIA E HADUMIT - HISTORIKU, ARKITEKTURA, PIKTURA DHE PLASTIKA</b> , <i>Dr. Fejz Drançolli</i>	
Arkitektura e xhamisë së Hadumit	27
Salla e lutjeve	27
Mihrabi dhe mimbëri	29
Mahfli	29
Elementet konstruktive, trompet	31
Hajati i xhamisë	33
Arkadat e hajatit	33
Minareja	33
Dekoracionet murale - arabeskat	37
Plastika gurore	38
<b>PROJEKTI I CHwB-së gjatë 2004 - 2005</b>	
Faza e dokumentimit	41
Përshkrimi i materialeve ndërtimore	41
Përshkrimi i dëmtimeve	48
<b>FAZA E IMPLEMENTIMIT</b>	
Minarja	57
Kupola	62
Portiku	64
Kornizat e dritareve dhe dyerve	67
Fasadat	71
Mbrojtja nga lagështia	74
Oborri	75
Materialet konservuese të përdorura	87
<b>ZERA TË TJERË PËR RESTAURIMIN E XHAMISË SË HADUMIT</b>	88
<b>PASTHËNIE</b> , <i>Ark. Dick Sandberg</i>	94
<b>LISTA E REFERENCAVE</b>	96



*Hadum Mosque in its surroundings*

*Xhamia e Hadumit dhe rrethina e saj*



## FOREWORD

*Regarding the exterior restoration and conservation works of the Hadum mosque 2003-2005*

### Project background

The restoration project started in 2000 when Andras Riedlmayer and Andrew Herscher from Kosovo Cultural Heritage Project (KCHP) in the US, got engaged in the Hadum mosque restoration and managed to arrange funding from Packard Humanities Institute.

In cooperation with the Islamic Society, the Ministry of Culture (MoC) and the Institute for Protection of Monuments (IPM) Gjakova, they agreed on the project and ordered measuring and design drawings from Turkish experts. Difficulties in finding skilled craftsmen and good material in the years after the war stopped the restoration in 2002, immediately after the portico had been covered by new lead and the cupola was emergency repaired against rain.

In 2003 Cultural Heritage without Borders (CHwB) was asked by KCHP to take over the responsibility for the project management. The restoration resumed, again involving the Turkish experts Professor Zeynep Ahunbay, Istanbul, responsible for the overall design and the Heritage supervision and Mustafa Pehlivanoglu, Architect, responsible for the design drawings.

### Works done in Hadum Mosque under the management of CHwB, 2003 - 2005

During the first six months of the CHwB's engagement, work focussed on finding and engaging the best possible experts and craftsmen. Parallel to this activity, an analysis was carried out of the existing building materials and a search was initiated for possible new materials to use. In the two summer periods of 2004 and 2005 the following works were carried out:

- Restoration of the minaret including reconstruction of the destroyed upper shaft.
- Stone conservation of the portico columns, facades, lower part of the minaret and window and doorframe stones, including removing all the

## PARATHËNIE

*Rreth punëve restauruese dhe konservuese të eksterierit të xhamisë në 2003-2005*

### Prapavija e projektit

Projekti i restaurimit filloi në vitin 2000, kur Andras Riedlmayer dhe Andrew Herscher nga Projekti i Trashëgimisë Kulturore të Kosovës (KCHP) në Sh.B.A, u angazhuan në Xhaminë e Hadumit dhe arritën të sigurojnë financimin nga Instituti i Shkencave Njerëzore Packard.

Në bashkëpunim me Bashkësinë Islame, Ministrinë e Kulturës (MK) dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve (IMM) të Gjakovës, ata u pajtuan rreth projektit dhe porositën projektin e matjeve dhe dizajnit nga ekspertët turq. Vështirësitë në gjetjen e mjeshtërvë të aftë dhe materialit të mirë në vitet e pasluftës shpesh në ndalimin e punëve restauruese në vitin 2002, menjëherë pas mbulimit të kulmit të hajatit me plumb të ri dhe mbulimit emergjent të kupolës kryesore për ta siguruar nga shiu.

Në vitin 2003, KCHP i ofroi Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (CHwB) që ta merr përsipër menaxhimin e projektit. Ne pranuan këtë ofertë dhe filluam restaurimin, duke i angazhuar sërish ekspertët turq: Profesor Zeynep Ahunbay nga Stambolli, përgjegjëse për dizajnin e përgjithshëm dhe mbikëqyrje në aspektin e trashëgimisë, si dhe Mustafa Pehlivanoglu, arkitekt, përgjegjës për vizatimet e dizajnit.

### Punët e kryera në Xhaminë e Hadumit nën menaxhimin e CHwB-së, 2003-2005

Gjatë gjashtë muajve të parë të angazhimit tonë, kemi punuar në mënyrë intensive në gjetjen dhe angazhimin e ekspertëve dhe mjeshtërvë më të mirë të mundshëm. Paralel me këtë aktivitet, ne analizuam materialet ekzistuese të objektit dhe hulumtuam materiale të reja të cilat do të mund të përdoshin. Në dy periudhat verore të viteve 2004 dhe 2005 pasuan këto punë:

- Restaurimi i minares duke përfshirë edhe rikonstruimin e petekut të shkatërruar.
- Konservimin e gurit të shtyllave të hajatit,



cement pointing and reparations, consolidation of the eroded stones and replacement of damaged stones.

- Change of the lead covering on the Praying Hall cupola.
- Restoration of the Portico including the columns, the stone cornice, the floor tiles, the badly burnt entrance door and the production of an entrance curtain.
- Decreasing of the moisture in the foundation and the walls by lowering the ground closest to the mosque, cleaning and repairing the foundation, adding a hydro isolation and by taking care of the rainwater on the surface closest to the building.
- Cleaning and restoration of the yard, including cleaning the gravestones and reparation of the walls around the yard.

A part from the above-mentioned works, a number of other smaller works have been carried out.

The restoration of the Hadum Mosque has been strongly supported by the heritage authorities in Kosovo, such as the Ministry of Culture/Heritage Division, the Institute for the Protection of Monuments (IPM) Kosovo and the local IPM.

#### **Funding 2003-2005**

Packard Humanities Institute, US, through KCHIP, has contributed with 200,000 US Dollars for the majority of the restoration works done. Swedish Sida has contributed with 60,000 Euros for stone conservation, Maintenance Program course, Maintenance Program for the mosque and the main part of the project management and administration cost.

**Dick Sandberg**

*Architect, Senior Heritage Advisor and former International Project Manager for CHwB in Kosovo*

fasadave, pjesës së poshtme të minares, gurëve të kornizave të deryve dhe dritareve, duke përfshirë edhe heqjen e mbushjeve nga llaçi i çimentos dhe riparimet, konsolidimin e gurëve të eroduar dhe zëvendësimin e atyre të dëmtuar.

- Ndërrimin e mbulesës së plumbit të kupolës mbi Sallën e Lutjeve.
- Restaurimin e hajatit duke përfshirë edhe shtyllat, kurorën e gurit, pllakat e dyshemesë, derën hyrëse të djegur dhe punimin e perdes së hyrjes.
- Zvogëlimi i lagështisë në themelet dhe muret duke e ulur nivelin e tokës përreth xhamisë, pastrimin dhe riparimin e themeleve duke i shtuar hidroizolim dhe mënjnauar ujin e shiut nga sipërfaqja afër objektit.
- Pastrimi dhe restaurimi i oborrit, duke përfshirë pastrimin e gurëve të varreve dhe riparimin e mureve të oborrit.

Pos këtyre punëve të përmendura, janë kryer edhe një numër i punëve më të vogla.

Restaurimi i Xhamisë së Hadumit është përkrahur fuqishëm nga autoritetet e trashëgimisë në Kosovë, si Ministria e Kulturës/Divizioni i Trashëgimisë, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës (MMK) të Kosovës dhe IMM-ja lokale.

#### **Financimi 2003-2005**

Instituti i Shkencave Njerëzore Packard, nga Sh.B.A.-të, nëpërmes KCHIP, ka kontribuar me 200,000 dollarë amerikanë për shumicën e punëve restauruese.

Sida suedeze ka kontribuar me 60,000 euro për konservimin e gurit, kursin për programet e mirëmbajtjes, Programin e Mirëmbajtjes për Xhaminë dhe pjesën kryesore të shpenzimeve të menaxhimit dhe administrimit të projektit.

**Dick Sandberg**

*Arkitekt, Këshilltar i Lartë për Trashëgimi dhe ish Menaxher Ndërkombëtar i Projekteve për CHwB-në në Kosovë*

## HERITAGE IN THE AFTERWAR

### Introduction

The restoration of the Hadum Mosque in Gjakova is an estimable achievement for all who participated in the restoration and all who use, appreciate or identify with the mosque. Yet, the meanings of the restoration are and will continue to be defined within the complex cultural politics of Kosovo. During the period of the Hadum Mosque's restoration, these cultural politics were shaped by 1998-99 war and its aftermath. I thus use the term "afterwar" as a name for this period, a period when the war's effects and even some of its processes were still salient.

In what follows, I will address some of the important roles that cultural heritage has played in Kosovo's afterwar in order to consolidate a context for the Hadum Mosque's restoration. Despite what this restoration might suggest, this context was not one in which there was a general effort to preserve or even value cultural heritage. Rather, it was a context in which a great deal of attention and energy was focused on the political instrumentalization of heritage. These instrumentalizations yielded conservation of some heritage but also destruction of other heritage, valuation of some heritage but also dismissal of other heritage, respect for some heritage but also neglect of other heritage. The restoration of the Hadum Mosque, then, exists less as a representative act than as one component of a complicated and heterogeneous network of social processes in which heritage is enmeshed.

### Heritage in War

The Hadum Mosque complex, consisting of the mosque itself and adjacent library, religious school and graveyard, was damaged first in war. The wartime damage to the complex was inflicted on March 24, 1999, the evening when NATO's airwar against Serbia began. Eyewitnesses reported that, around midnight, Serb police and paramilitary began to set fire to the bazaar around the mosque complex; the resulting blaze was captured on a US Department of Defense satellite photograph.

The fire burned the wooden portico of the mosque

## TRASHËGIMIA PAS LUFTËS

### Hyrje

Restaurimi i Xhamisë së Hadumit në Gjakovë është një arritje e admirueshme për të gjithë ata që morën pjesë në restaurim dhe për të gjithë ata që e përdorin, çmojnë apo identifikohen me këtë xhami. Por, rëndësia e restaurimit definohet dhe do të vazhdojë së definuar përbrenda politikave komplekse të trashëgimisë në Kosovë. Gjatë periudhës së restaurimit të Xhamisë së Hadumit, këto politika u formësuan nga lufta e viteve 1998-1999 dhe pasojat e saj. Për këtë arsye, e përdora termin "pasluftë" si emërtim për këtë periudhë, periudhë në të cilën pasojat e luftës dhe disa nga proceset e saj ende ndjeheshin.

Më poshtë do të trajtoj disa nga rolet e rëndësishme që trashëgimia kulturore i ka luajtur në Kosovën e pasluftës, me qëllim të konsolidimit të kontekstit të restaurimit të Xhamisë së Hadumit. Përkundër sugjerimit të mundshëm që mund të perceptohet nga ky restaurim, ky rast nuk i takonte përpjekjeve të përgjithshme për ruajtjen apo vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Për më tepër, pjesa më e madhe e vëmendjes dhe energjisë në këtë kontekst është fokusuar në instrumentalizimin politik të trashëgimisë. Ky instrumentalizim rezultoi me konservimin e një pjese të trashëgimisë, por edhe shkatërrimin e trashëgimisë tjetër, vlerësimin e një pjese të trashëgimisë por edhe mohimin e pjesës tjetër të trashëgimisë, respektimin e një trashëgimie dhe neglizhimin e trashëgimisë tjetër. Në këtë aspekt, restaurimi i Xhamisë së Hadumit paraqitet më pak si veprim reprezentativ dhe më shumë si një komponentë e rrjetës së komplikuar dhe heterogjene të proceseve sociale në të cilat është e ndërlikuar trashëgimia.

### Trashëgimia në luftë

Kompleksi i Xhamisë së Hadumit, i përbërë prej vetë xhamisë dhe bibliotekës pranë saj, mejtepit dhe varrezave, së pari u dëmtua gjatë luftës. Gjatë luftës, kompleksi u dëmtua me 24 mars 1999, në natën kur NATO-ja filloi bombardimet kundër Serbisë. Dëshmitarët okular raportuan që, rreth mesnatës, policia dhe paramilitarët serbë filluan t'i vejnë flakën çarshisë përreth xhamisë, duke rezul-

and damaged its intricately painted front façade and interior surfaces; in addition, the top third of the mosque's minaret was shot off, probably by a rocket-launched grenade. The mosque's adjacent library, built in the early 18th century, was more significantly damaged; its collection of books and manuscripts was destroyed, as was a portion of the building itself. The religious school across the courtyard of the mosque complex was also damaged in the fire.

The type of damage inflicted on the mosque, library, religious school, and surrounding bazaar was common in 1998 and 1999, during the campaign waged by Serb forces against the Kosova Liberation Army. During this period, along with the mass expulsion of Albanians from Kosova, religious sites associated with Islam were frequently targeted for destruction. Approximately 200 of the more than 600 mosques in Kosova were damaged or destroyed


tuar në një flakë të madhe e cila u regjistrua edhe në fotografitë satelitore të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes.

Flaka dogji portikun e xhamisë, i cili ishte i punuar nga druri, si dhe dëmtoi fasadën ballore dhe sipërfaqet e enterierit që ishin të pikturuara me mjeshtri. Për më tepër, një e treta e minares së xhamisë ishte granatuar, sipas të gjitha gjasave me bazukë. Biblioteka e cila gjendej pranë xhamisë, e ndërtuar në fillim të shekullit XVIII, ishte dëmtuar edhe më shumë. Koleksioni i librave dhe dorëshkrimeve ishte shkatërruar plotësisht, ashtu sikur një pjesë e vetë ndërtesës së bibliotekës. Mejtepi, që gjendej përballë oborrit të kompleksit të xhamisë, gjithashtu u dëmtua nga zjarri.

Dëmet e shkaktuara ndaj xhamisë, bibliotekës, mejtepit dhe çarshisë përreth ishin të zakonshme në 1998 dhe 1999, gjatë kampanjës së udhëhequr nga


*Hadum Mosque  
before the war*

*Xhamia e Hadumit  
para luftës*



*Hadum Mosque  
after the war*

*Xhamia e Hadumit  
pas luftës*



during 1998 and 1999, along with Sufi lodges and Islamic schools, archives and libraries. The vast majority of this violence was not the result of collateral damage inflicted in the course of military operations; buildings were ruined by deliberately inflicted violence, including vandalism, arson, the shelling or toppling of minarets, and the dynamiting of buildings from within. In some contexts, Islamic religious sites were the only buildings singled out for destruction; in other contexts, they comprised one component of a landscape of ruined architecture.

Violence against Islamic religious sites in the 1998-1999 campaign accompanied a range of other forms of violence, ranging from the forced expulsion of Albanian communities from their homes, through robbery and extortion, to rape and murder. Violence against religious sites served to code all this violence as ethnic, as part of a history of ethnic conflict between Albanians and Serbs, and thus, to legitimate and justify this violence in the context of ethno-nationalist ideology.

### **Heritage in the Afterwar**

The cessation of hostilities between NATO and Serbia in June 1999 did not mark the cessation of violence against heritage in Kosovo. Instead, heritage continued to be targeted for destruction, although in the afterwar it was generally different heritage targeted for different reasons.

The already-damaged Hadum Mosque complex received further damage in the context of its post-war restoration. In May 2000, around a year after the end of the war, the Saudi Joint Relief Committee received permission to restore the damaged mosque complex. Among the first works undertaken at the site, however, were the bulldozing of the damaged library and religious school. These were the preparatory steps towards clearing all buildings around the mosque and opening space for the construction of a new religious center. Like the wartime damage inflicted on the mosque, the damage inflicted in this "restoration" was also symptomatic; throughout Kosovo, as had already taken place in Bosnia, restorations of damaged mosques were often ideologically inspired. These "restora-

forcat serbe kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, së bashku me dëbimin në masë të shqiptarëve nga Kosova, objektet fetare të asocuara me islamin ishin shpesh cak i shkatërrimeve. Rreth 200 prej më shumë se 600 xhamive në Kosovë janë dëmtuar apo shkatërruar gjatë viteve 1998 dhe 1999, ashtu sikur edhe shumë teqe e mejtepe, arkive dhe biblioteka. Pjesa më e madhe e kësaj dhune nuk ishte rezultat i dëmeve anësore të operacioneve ushtarake; objektet u shkatërruan nga dhuna e qëllimshme, duke përfshirë vandalizmin, zjarrvënjen, granatimin apo rrëzimin e minareve, dhe shkatërrimin e objekteve me dinamit të vendosur brenda tyre. Në disa raste, objektet fetare islame ishin të vetmet objekte që u shkatërruan, në rastet tjera ato ishin vetëm një komponentë e komplekseve të tëra arkitektonike që u shkatërruan.

Dhuna kundër objekteve fetare islame në kampanjën e 1998-1999 u përcoll me një sërë formash tjera të dhunës, duke filluar nga dëbimi i dhunshëm i shqiptarëve nga shtëpitë e tyre, plaçkitjet dhe shantazhet, e deri te përdhunimet e vrasjet. Dhuna kundër objekteve religjioze shërbeu që e tërë kjo dhunë të kodohet si etnike, si pjesë e historisë së konfliktit etnik mes shqiptarëve dhe serbëve, dhe si e tillë, ta legjitimojë dhe arsyetojë këtë dhunë në kontekstin e ideologjisë etnike e nacionaliste.

### **Trashëgimia pas luftës**

Përfundimi i armiqësisë mes NATO-s dhe Serbisë në qershor 1999 nuk shënoi edhe përfundimin e dhunës ndaj trashëgimisë në Kosovë. Përkundrazi, trashëgimia vazhdoi të jetë cak i shkatërrimit, edhe pse në periudhën e pasluftës në përgjithësi u sulmua një lloj tjetër i trashëgimisë dhe për shkaqe të tjera.

Kompleksi i Xhamisë së Hadumit, tanimë i shkatërruar, u dëmtua edhe më tej në kontekstin e restaurimit të pasluftës. Në maj të vitit 2000, rreth një viti pas përfundimit të luftës, Komiteti i Bashkuar Arab për Ndihmë morri lejen që ta restaurojë kompleksin e dëmtuar të xhamisë. Por, ndër punët e para që u kryen ishte rrafshimi me buldozer i bibliotekës dhe mejtepit. Këto ishin hapat përgatitor drejt rrafshimit të të gjithë objekteve përreth xhamisë për t'i liruar vend ndërtimit të një qendre

tions" yielded the transformation of those mosques into forms more appropriate to the organizations that funded "restorations" than to the congregations and communities that used them.

After the bulldozing had taken place, however, the United Nations Mission in Kosovo intervened in the mosque's restoration. It solicited the American NGO, Kosovo Cultural Heritage Project, to sponsor the restoration, which this NGO did in the following years, working with the Swedish NGO, Cultural Heritage without Borders, as implementing partner. The essay in this book by Dick Sandberg, director of Cultural Heritage without Borders' Prishtina office, details the history of this restoration.

More generally, though, the story of the Hadum Mosque in the years after the war reveals that postwar reconstruction—the name generally given to the period after the war—does not immediately or automatically imply the end of destruction. In fact, heritage in postwar Kosova has remained under threat in the years after the war's end, threats not only from ideologically-saturated restoration and reconstruction schemes, but also from political violence and economic development.

The architectural targets of political violence in postwar Kosova comprise heritage associated with Kosova's Serb community: Serb Orthodox churches, monasteries, cemeteries, and monuments. Between the end of war in June 1999 and the completion of the Hadum Mosque's restoration in 2005, some 150 Orthodox churches and monasteries has been damaged or destroyed in Kosova. In Gjakova itself, during the years when the Hadum Mosque was under restoration, the Holy Trinity Cathedral, the most important Orthodox church in the city, was vandalized and burned and its site was then completely cleared. Gjakova now exists as a city that is ethnically and culturally homogenous, as all of its former Serb citizens have either left or been expelled and all of the landmarks related to these citizens have been destroyed. This destruction served much the same purpose as did war-time destruction; it has coded the conflict in Kosova in ethnic terms, as a conflict between Albanians and Serbs, rather than a conflict about political sover-

të re fetare. Sikur edhe dëmet që i pësoi kjo xhami gjatë luftës, ashtu edhe dëmet e shkaktuara gjatë këtij "restaurimi" ishin simptomatike; në tërë Kosovën, siç ishte rasti i mëparshëm në Bosnjë, restaurimi i xhamive të dëmtuara shpesh ishte i inspiruar ideologjikisht. Këto "restaurime" rezultuan me transformimin e këtyre xhamive në forma që ishin më të përshtatshme për organizatat që financin këto "restaurime" se sa për xhematin dhe komunitetin që i përdornin.

Sidoqoftë, pas shkatërrimit me buldozer të rrethinës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) intervenoi në restaurimin e xhamisë. UNMIK-u kërkoi nga OJQ-ja amerikane, Projekti Kosovar i Trashëgimisë Kulturore ("Kosovo Cultural Heritage Project") që ta sponsorojë restaurimin, gjë që kjo OJQ pranoi dhe në vitet në vijim punoi së bashku me OJQ-n suedeze, Trashëgimia Kulturore pa Kufij ("Cultural Heritage without Borders"), si partnere implementues. Shkrimi në këtë publikim i Dick Sandbergut, shefit të zyrës së Trashëgimisë Kulturore pa Kufij në Prishtinë, shpjegon në detaje historinë e këtij restaurimi.

Në vija më të përgjithshme, rrëfimi për Xhaminë e Hadumit në vitet e pasluftës tregon se rindërtimi i pasluftës - emri që përgjithësisht i jepet periudhës pas luftës - gjithnjë nuk nënkupton fundin e menjëhershëm apo automatik të shkatërrimit. Në fakt, trashëgimia në Kosovën e pasluftës mbeti e kërcënuar edhe në vitet pas luftës; këto kërcënime nuk ishin vetëm nga skemat e restaurimeve dhe rindërtimeve të motivuara nga ideologjitë, por edhe nga dhuna politike dhe zhvillimi ekonomik.

Caqet arkitektonike të dhunës politike në Kosovën e pasluftës përbëhen nga trashëgimia e asocuar me komunitetin serb të Kosovës: kishat ortodokse serbe, manastiret, varrezat dhe monumentet. Mes përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999 dhe përfundimit të restaurimit të Xhamisë së Hadumit në vitin 2005, rreth 150 kisha dhe manastire ortodokse janë dëmtuar apo shkatërruar në Kosovë. Vetëm në Gjakovë, gjatë viteve kur Xhamia e Hadumit po restaurohej, Katedralja e Treshës së Shenjtë, që ishte kisha më e rëndësishme ortodokse në qytet, u vandalizua dhe u djeg, kurse vendi ku



eignty, social justice, or human rights. The success of this coding in mobilizing support, in both Albanian and Serb contexts, can be seen in the unfortunate ubiquity of destruction in Kosovo both during and after the war.

In addition, however, uncontrolled economic development in many Kosovar towns and cities has also resulted in the destruction of architectural and urban heritage. In the context of the afterwar, where the rule of law is weak, where the regulation of construction is a rather low government priority, and where the collective cultural value of heritage is far less salient to the owners of historic buildings than the market value of private property, it may be more accurate to speak of postwar redestruction than postwar reconstruction. In Prishtina, in fact, more historic buildings have been destroyed after the war, through uncontrolled urban rebuilding, than during the war itself.

In the context of peacetime, this process is understood as capitalism's "creative destruction," the incessant destruction and reconstruction of cities in the interest of maximizing property value. In the post-conflict context of Kosovo, however, creative destruction continues and at times intensifies the violent destruction of war. The continuity between the destruction of war and the redestruction that follows has made the process of reconstruction in Kosovo very ambivalent; it is difficult to say with precision what, exactly, is being reconstructed.

ndodhej katedralja u spastrua plotësisht. Tani, Gjakova është një qytet homogjen si në aspektin etnik ashtu edhe në atë kulturor, pasi që të gjithë qytetarët e dikurshëm serbë kanë braktisur qytetin apo janë dëbuar, kurse të gjitha monumentet që lidhen me këta njerëz janë shkatërruar. Ky shkatërrim kishte qëllimin përafërsisht të njëjtë si ai gjatë luftës; e ka koduar konfliktin në Kosovë me terme etnike, si konflikt mes shqiptarëve dhe serbëve, e jo si konflikt për sovranitet politik, barazi sociale apo të drejta njerëzore. Suksesi i këtij kodifikimi në mobilizimin e përkrahjes si në rastin e shqiptarëve ashtu edhe në atë të serbëve mund të shihet në shkatërrimin i cili fatkeqësisht ka ndodhur çdokund në Kosovë gjatë dhe pas luftës.

Për më tepër, zhvillimi i pakontrolluar ekonomik në shumicën e qyteteve dhe qytezave të Kosovës gjithashtu ka rezultuar me shkatërrimin e trashëgimisë arkitektonike dhe urbane. Në kontekstin e periudhës së pasluftës, ku sundimi i ligjit është i dobët, ku rregullimi i ndërtimit nuk është ndër prioritetet kryesore të qeverisë dhe ku vlerat kolektive kulturore të trashëgimisë janë shumë më pak të rëndësishme se sa vlera e tregut të pronës private, do të ishte më e drejtë të flitet për rishkatërrimin e pasluftës se sa për rindërtimin e pasluftës. Në Prishtinë, në të vërtetë, më shumë objekte historike janë shkatërruar pas luftës, përmes ndërtimit të pakontrolluar urban, se sa gjatë vetë luftës.

Në kontekstin e paqes, ky proces nënkuptohet si "shkatërrimi kreativ" i kapitalizmit - shkatërrimi dhe rindërtimi i vazhdueshëm i qyteteve në interes të maksimalizimit të vlerës së pronës. Sidoqoftë, në Kosovën e pasluftës, shkatërrimi kreativ vazhdon, dhe kohë pas kohe e intensifikon shkatërrimin e dhunshëm të luftës. Vazhdimësia mes shkatërrimit të luftës dhe rishkatërrimit që pasoi e ka bërë procesin e rindërtimit në Kosovë të jetë shumë ambivalent; është vështirë të thuhet me saktësi se çka po rindërtohet në të vërtetë.



*Destruction of Market Street in Gjakova*

*Shkatërrimi i Çarshisë së Madhe në Gjakovë*

### The Impossibility of Restoration

Yet, the most profound ambivalence of restoration is not political, I would suggest, but conceptual, embedded within the idea of restoration itself. Restoration's deepest dilemma is not that it often is carried out inadequately or that it is structured by political ideology, but that, in being carried out at all, it denies the finality of destruction, the impossibility of restoring all that destruction eliminates, and the necessity of rejecting and mourning destruction, rather than explaining, defending or even overcoming it.

This idea was expressed eloquently by the Croatian writer, Dubravka Ugresic, in "The Tale of the Bomb and the Book." The essay deals with the destruction of the National Library in Sarajevo-a building that was destroyed during the siege of Sarajevo and has yet to be restored. Ugresic writes:

*"An object that has been destroyed is not replaceable; it disappears forever. Devastation is never solely material; it has multiple aspects, multiple meanings, but it is always final. We shall build new libraries and publish new books, announce the optimists, accustomed to a regular rhythm of destruction and rebuilding. But the idea of reconstruction contains the notion of future destruction."*

Architecture itself is never guilty and never innocent, never wrong and never right, never political but only politicized. For these reasons, the restoration of the Hadum Mosque should be celebrated, the destruction of buildings revered by other cultures, other communities and other citizens should be condemned, and we should always keep in mind both the fragility of restoration and the irrevocability of destruction.

Dr. Andrew Herscher

### Pamundësia e restaurimit

Por, ambivalenca thelbësore e restaurimit nuk është politike, por do të thosha, është më tepër konceptuale, dhe e mishëruar në vetë idenë e restaurimit. Dilema më e thellë e restaurimit shpesh nuk është nëse ai është kryer në mënyrë joadekuate apo është i strukturuar nga ideologjia politike, por nëse, në kryerjen e tij, po e mohojmë fatalitetin e shkatërrimit, pamundësinë e restaurimit e të gjithë asaj që shkatërrimi eliminon, dhe nevojën për të refuzuar dhe vajtuar shkatërrimin, më parë se ta shpjegojmë, mbrojmë apo edhe tejkalojmë.

Këtë ide e shprehu në mënyrë elokvente shkrimtarja kroate, Dubravka Ugresic, në "Përrallën për bombën dhe librin". Eseu trajton shkatërrimin e Bibliotekës Kombëtare në Sarajevë - objekt i cili u shkatërrua gjatë rrethimit të Sarajevës dhe ende nuk është restauruar. Ugresic shkruan:

*"Një objekt i cili është shkatërruar plotësisht nuk është i zëvendësueshëm; ai zhduket përgjithmonë. Shkatërrimi kurrë nuk është vetëm material; ai ka kuqtime të shumta, por gjithnjë është përfundimtar. Ne do të ndërtojmë biblioteka të reja dhe do të botojmë libra të ri, thonë optimistët e mësuar me ritmin e rregullt të shkatërrimit dhe rindërtimit. Por, ideja e rindërtimit në vete përmban nocionin e shkatërrimeve të ardhshme".*

Vetë arkitektura kurrë nuk është fajtores dhe kurrë nuk është e pafajshme, kurrë nuk është gabim por kurrë nuk ka të drejtë, kurrë nuk është politike por vetëm e politizuar. Për këto arsye, restaurimi i Xhamisë së Hadumit duhet të kremtohet, shkatërrimi i objekteve të adhuruara nga kulturat, komunitetet dhe njerëzit e tjerë duhet të dënohet, dhe gjithnjë duhet ta kemi parasysh brishtësinë e restaurimit dhe pakthyeshmërinë e shkatërrimit.

Dr. Andrew Herscher

## CONTEXT OF HADUM MOSQUE IN OTTOMAN/BALKAN ARCHITECTURE

### **Ottoman architecture: Its architectural vocabulary and representation in the Balkans**

Ottoman architecture started in and around Iznik (ancient Nicaea) within the 14th century. Yesil Cami (1378-1392), Imaret of Nilufer Hatun, Madrasa of Suleyman Pasha, several baths and modest tombs in Iznik make up an important part of the legacy of early Ottoman period. As the Ottoman State expanded in the region, Bursa, a city famous for its silk production became the second capital of the Ottomans. Ottoman Bursa grew extensively outside the Hellenistic walls, with its religious and commercial center around a Friday Mosque, founded by Bayezit I at the end of the fourteenth century.

Ottomans set foot on European soil (Rumeli) during the reign of Murad I; interesting architectural ideas were expressed in the religious and civil buildings they constructed during their advance in northern Greece, Kosovo and Bulgaria within the fourteenth and fifteenth centuries. Edirne (ancient Hadrianopolis) was overtaken by the Ottomans in the second half of the fourteenth century and served as their capital from late fourteenth century

## KONTEKSTI I XHAMISË SË HADUMIT NË ARKITEKTURËN OSMANE DHE TË BALLKANIT

### **Arkitektura osmane: artikulimi arkitektonik dhe përfaqësimi në Ballkan**

Arkitektura osmane filloi në dhe përreth Iznikut (Nicea antike) diku në shekullin e XIV. Yesil Cami (1378-1392), Imareti i Nilufer Hatunit, Medresa e Suleyman Pashës, disa hamame dhe varre modeste në Iznik përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë së hershme osmane. Me zgjerimin e shtetit osman në rajon, Bursa, një qytet i famshëm për prodhimin e mëndafshit, shndërrohet në kryeqytetin e dytë të osmanëve. Bursa e periudhës osmane rritej vazhdimisht përtej mureve të periudhës helene, dhe qendrën religjioze dhe tregtare e kishte përreth Xhamisë së Premtes, të themeluar nga Bayezit I në fund të shekullit të XIV.

Osmanët shkelën në tokën e Evropës (Rumeli) gjatë sundimit të Muradit I; gjatë depërtimit të tyre në Greqinë veriore, Kosovë dhe Bullgari, në shekujt XIV dhe XV, fillojnë të shprehin ide interesante arkitektonike. Edirne (Hadrianopolisi antik) u pushtua nga osmanët në pjesën e dytë të shekullit të XIV dhe u shfrytëzua si kryeqyteti i tyre prej fundit të shekullit XIV e deri në rënien e

*Istanbul, Suleymaniye Mosque  
957-964H./1550-1557*

*Stamboll, Xhamia Suleymaniye  
957-964H./1550-1557*



until the fall of Constantinople in mid fifteenth century. Edirne was an important center of commerce and its position on the main road connecting the capital to the Balkans made the city flourish with monuments. Among the imperial complexes built in the town, those of Bayezit II (1484-1488) and Selimiye towards the end of the 16th century are masterpieces of Ottoman architecture.

During the five centuries of Ottoman presence in the Balkans, the religious architecture was one of the major fields of cultural activity, reflecting the arts and crafts, as well as the economic and political power of the Ottomans. Edirne, Thessaloniki, Sophia, Skopje, Prishtina are cities where the religious architecture of the early period is well represented. Along with the religious buildings (mosques, convents), Ottomans built schools (madradas and primary schools), commercial buildings (arastas, bedestens, caravanserais), hospitals (darussifas), public baths, inns, water conveyance systems, fountains, military buildings (castles, barracks) at various locations, as a result of which it is possible to see significant representatives of their architecture in the Balkans.

The study of Ottoman Architecture is generally divided into periods, according to its stylistic development. The early period is from the foundation of the Ottoman State to the conquest of Istanbul. The presence of Byzantine buildings and builders in the region influenced the construction techniques and decoration of the buildings designed in the 14th and early 15th centuries. The period from mid 15th to end of 17th century is regarded as the Classical Period of Ottoman Architecture. Haghia Sophia, the majestic monument of Byzantine architecture in Istanbul had great impact on the large domed mosque structures of the Ottomans. 16th century was a time of intensive building all over the Empire; with several major projects taking place at the capital city Istanbul during the time of architect Sinan's office as the chief architect. His work is the epitome of Ottoman architecture at its zenith. The norms set by the office of the imperial architect were disseminated to the provinces by decrees and missions of the court architects. So it is possible to see mosques, bridges and other civil buildings all

Konstantinopojës, në mes të shekullit të XV. Edirne ishte një qendër e rëndësishme tregtare dhe pozita e saj në rrugën kryesore që e lidhte kryeqytetin me Ballkanin bëri që monumentet në të të lulëzojnë. Në mesin e komplekseve perandorake që u ndërtuan aso kohe në qytet, ato të Bayezit II (1484/1488) dhe Selimiye, kah fundi i shekullit të XVI, janë kryevepra të arkitekturës osmane.

Gjatë pesë shekujve të prezencës osmane në Ballkan, arkitektura fetare ishte njëra nga fushat më të gjëra të aktivitetit kulturor, duke reflektuar artin dhe mjeshtërinë, si dhe fuqinë ekonomike dhe politike të osmanëve. Edirne, Selaniku, Sofja, Shkupi, Prishtina janë qytete ku arkitektura fetare e periudhës së hershme është mjaft prezente. Së bashku me objektet fetare (xhamitë, manastiret), osmanët ndërtuan edhe shkolla (medrese dhe shkolla fillore), objekte tregtare (arasta, bezistane, bujtina), spitale, banja publike, konaq, sisteme të ujësjellësit, shatërvanë, objektet ushtarake (kështjella, baraka) në lokacione të ndryshme, dhe si rezultat i kësaj lehtë mund të vërehen shembujt e rëndësishëm reprezentativë të arkitekturës së tyre në Ballkan.

Studimi i arkitekturës osmane përgjithësisht ndahet në periudha, varësisht nga zhvillimi stilistik. Periudha e hershme është prej themelimit të Shtetit Osman e deri te pushtimi i Stambollit. Prezenca e objekteve dhe ndërtuesve bizantinë të rajonit pati ndikim në teknikat e ndërtimit dhe dekorimet e objekteve të ndërtuara në shekullin e XIV dhe fillim të shekullit XV. Periudha prej mesit të shekullit XV e deri në fund të shekullit XVII konsiderohet si Periudha Klasike e Arkitekturës Osmane. Haghia Sophia, monumenti madhështor i arkitekturës bizantine në Stamboll, ka pasur ndikim të madh në strukturën e xhamive me kupola të mëdha të ndërtuara nga Osmanët. Shekulli i XVI ishte kohë e ndërtimeve intensive në tërë Perandorinë, me disa projekte madhore që u implementuan në kryeqytetin Stamboll, gjatë kohës kur arkitekt Sinani punonte si kryearkitekt i perandorisë. Veprat e tij janë mishërimi i arkitekturës osmane në zenitin e saj. Normat e vendosura nga zyra e kryearkitektit perandorak u shpërndanë nëpër provinca në formë të dekretëve dhe misionëve të arkitektëve të obor-

over the Ottoman Empire, designed with unity of style and proportions, making them distinctly Ottoman.

The period between 1700 and 1730 is known as the Tulip Period, due to the love for this flower. This interest was reflected in the architecture of the period; tulips, carnations and other flowers in vases were used widely to decorate the interior and exterior surfaces of houses, palaces and fountains. The Yemis Odasi in Topkapi Palace and several public fountains in Istanbul and other cities reflect the merry, lighthearted atmosphere of the period.

18th century was a time when Ottomans had close diplomatic relations with France. As a result of artistic and commercial contacts and exchanges with Italy and France, rococo and baroque style objects and architectural decoration became fashionable in the Ottoman Empire, finally leading to the development of the Ottoman Baroque style which is also visible in the decoration of Hadum Mosque.

#### **Ottoman mosques - variety and symbolism**

Traces of Ottoman presence is visible on many Balkan towns. The most striking element is usually a domed mosque, visible among smaller sized houses. The commercial buildings, industrial activities were usually located around the market place. Arastas, streets lined with shops of upholstery,

rit. Për këtë arsye, hasim në xhami, ura dhe objekte të tjera publike në tërë Perandorinë Osmane, të projektuara me unitet në stil dhe proporcione, gjë që i dallon ato si osmane.

Periudha mes viteve 1700 dhe 1730 njihet si Periudha e Tulipanit, për shkak të dashurisë së shprehur për këtë lule. Ky interesim është shprehur në arkitekturën e kohës; tulipanët, karafilat dhe lule të tjera në vazo u përdoren për dekorimin e shumë enterierëve dhe eksterierëve të shtëpive, pallateve dhe shatërvanëve. Yemis Odasi në Pallatin Topkapi dhe disa shatërvanë publikë në Stamboll dhe qytete tjera reflektojnë atmosferën e gëzuar e gazmore të kësaj periudhe.

Shekulli i XVIII ishte koha kur osmanët patën lidhje të ngushta diplomatike me Francën. Si rezultat i kontakteve dhe shkëmbimeve artistike dhe tregtare me Italinë dhe Francën, stili barok dhe rokoko në objekte dhe dekorime arkitektonike u bë i modës në Perandorinë Osmane, duke çuar kështu në zhvillimin e stilit të Barokut Osman, i cili gjithashtu mund të shihet në Xhaminë e Hadumit.

#### **Xhamitë osmane - shumëllojshmëria dhe simbolizmi**

Gjurmët e prezencës osmane janë të dukshme në shumë qytete të Ballkanit. Elementi më dominues zakonisht janë xhamitë me kupola, të cilat dallohen nga shtëpitë e vogla. Objektet tregtare dhe

*Bursa, Great Mosque (Ulu Cami)  
1396-1400*


*Bursë, Xhamia e Madhe (Ulu Cami),  
1396-1400*





*Istanbul, Hadim Ibrahim Pasha Mosque, 958 H./1551*

*Stamboll, Xhamia e Hadim Ibrahim Pashës, 958 H./1551*



blacksmiths, coppersmiths, jewellers, bookbinders and other guilds showed the trades and crafts active in the social, cultural and economic life of the towns.

Design of mosques was important in the development of Ottoman architecture. The early Ottoman mosques were single domed or cross-axial structures. Mosques in Iznik and were usually combined with guest rooms, which were devoted to the accommodation of travelling dervishes. This type of religious buildings were erected in the Balkans until late 15th century. The multi-domed Friday mosque type which had its root in early Islamic mosques, was modified by the Ottomans and found a new expression in the Ulu Cami of Bursa (1399). Several examples of the Friday mosque were built in the Balkans, in Edirne, Sophia and elsewhere until late fifteenth century. Starting with Uc Serefeli Mosque (1437-1447) in Edirne, however, the large domed and lead roofed mosques prevailed in the architectural scene. Ottoman architects concentrated their attention on finding means to support larger domes which would crown spacious, well-lit, impressive interiors. The combination of

aktivitetet industriale zakonisht janë vendosur përreth tregjeve. Arastat, rrugët të cilat në të dyja anët kishin dyqane të tapicerive, farkëtarëve, bakërpunuesve, argjendarëve, libërlidhësve dhe zanateve të tjera, dëshmonin për zanatet dhe tregtitë të cilat praktikoheshin në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të qyteteve.

Dizajni i xhamive ishte i rëndësishëm në zhvillimin e arkitekturës osmane. Xhamitë e hershme osmane kishin strukturë një-kupolëshe apo me akse të kryqëzuara. Xhamitë në Oznik dhe Bursë zakonisht ishin të kombinuara me dhoma për mysafirë, të cilat kryesisht shërbenin për akomodimin e dervishëve udhëtarë. Ky lloj i objekteve është ndërtuar në Ballkan deri në fund të shekullit të XV. Tipi i xhamisë me shumë kupola si ajo e Xhamisë së Premtes, që kishte rrënjët te xhamitë e hershme islame, u modifikua nga osmanët dhe gjeti një shprehje të re në Ulu Cami në Bursë (1399). Disa shembuj të Xhamisë së Premtes u ndërtuan në Ballkan, në Edirne, Sofje dhe vende të tjera deri në fund të shekullit të XV. Sidoqoftë, me ndërtimin e Xhamisë Uc Serefeli (1437-1447) në Edirne, në skenën arkitektonike filluan të dominojnë xhamitë me kupola të mëdha dhe të mbuluara me plumb. Arkitektët osmanë përqendruan vëmendjen e tyre në gjetjen e mënyrave për mbështetjen e kupolave edhe më të mëdha që do të kurorëzonin enterierët madhështorë, të hapur dhe të ndriçuar mirë, Kombinimi i kupolave dhe gjysëmkuqolave ishte një shpikje e rëndësishme në evolucionin e dizajnit të xhamive.




*Mostar, Karagoz Bey Mosque, 965H./1577/8*

*Mostar, Xhamia e Karagoz Bejit, 965H./1577/8*



*Maglaj, Kalavun Yusuf Pasha Mosque, 17th century*

*Maglaj, Xhamia e Kalavun Yusuf Pashës, shek. XVII*



domes with semidomes was an important innovation in the evolution of mosque design.

The first Fatih Mosque in Istanbul, which was destroyed in the earthquake of 1766, was a domed structure, with the appendage of a semidome in the southeast direction. In similar fashion, the Husrev Begova Mosque in Sarajevo (1529-1543) incorporated a semidome in the qibla direction. With three and more semidomes surrounding the central dome, architects could achieve results which were unprecedented in mosque interiors and exteriors. Sehzade, Mihrimah Sultan (Scutari), Sultan Ahmet mosques contribute to the cityscape of Istanbul with their domes and semidomes arranged in pyramidal sequences. Their interiors, decorated with marbles, tiles, coloured glass, mother of pearl and paintwork, are overwhelming with the unifying effect of the central dome and the hierarchical order of the side spaces.

#### **Hadum Mosque - its architecture and special features**

Hadum Mosque, the largest mosque in Gjakova is a single domed space with a three bay portico and a minaret at the southwest corner. It was part of a complex comprising a primary school, a library and shops. The mosque with its stone structure and dome follows the classical Ottoman tradition, while the school was more traditional and influenced by the civil architecture of the region. The library, which reflected the baroque style of the 18th century, had been added to the complex later.

Hadum Mosque is a medium sized mosque of the Ottoman Classical period. Its portico has the smallest number of arched units which could be connected to a single domed mosque. Here the porch is covered by a dome in the center and vaults on the sides. The entrance bay is not accentuated. Similar mosque designs were used widely in the region. The extant examples in Prizren (Sinan Pasha), Peja (Bayrakli), Mostar (Karagoz Bey) and Sarajevo (Ali Pasina) provide means of comparison.

The walls of the mosque are not very high, in contrast to several other mosques in the region. The dome rests on the walls but the cornice line is not

Xhamia e parë Fatih në Stamboll, e cila u shkatërrua në tërmetin e vitit 1766, kishte strukturë kupole, me një shtesë në formë të gjysëmkuopolës në pjesën juglindore. Me një stil të ngjashëm, Xhamia e Husrev Begut në Sarajevë (1529-1543) ka të inkorporuar një gjysëmkuopolë në drejtim të kiblës. Me nga tre apo me tepër gjysëmkuopola të cilat e rrethonin kupolën qendrore, arkitektët arritën rezultate të cilat ishin pa presedan në enterierët dhe eksterierët e xhamive. Xhamitë Sehzade, Mihrimah Sultan (Scutari) dhe Sultan Ahmet i kontribuojnë panoramës së Stambollit me kupolat dhe gjysëmkuopolat e tyre të vendosura në sequenca piramidale. Enterierët e tyre, të dekoruar me mermër, pllaka, xham të ngjyrosur, sedef dhe piktura, janë mbresëlënës me efektet unifikuese të kupolës qendrore dhe rendin hierarkik të hapësirave anësore.

#### **Xhamia e Hadumit - karakteristikat arkitektonike dhe të veçanta**

Xhamia e Hadumit, xhamia më e madhe në Gjakovë, është hapësirë njëkupolëshe me hajat trepjesësh dhe minare në këndin jugperëndimor. Xhamia ishte pjesë e kompleksit të përbërë nga shkolla filllore, një bibliotekë dhe dyqane. Xhamia me strukturën e saj prej gurëve dhe kupolës përcjellë traditën klasike osmane, përderisa shkolla ishte më tepër tradicionale dhe e ndikuar nga arkitektura qytetare e rajonit. Biblioteka, e cila reflektonte stilin barok të shekullit të XVIII, iu shtua kompleksit më vonë.


Xhamia e Hadumit është xhami me madhësi mesatare e periudhës Klasike Osmane. Portiku i saj e ka numrin më të vogël të njëjësive harkore të cilat duhet të lidhen me xhaminë njëkupolëshe. Këtu, hajati është i mbuluar me kupolë në qendër dhe qemerë në dy anët. Platforma e hyrjes nuk është e theksuar. Dizajni i ngjashëm i xhamive është përdorur edhe në vende tjera të rajonit. Shembujt ekzistues në Prizren (Sinan Pasha), Pejë (Bajrakli), Mostar (Karagoz Bey) dhe Sarajevë (Ali Pasina) mund të shërbejnë si krahasim.

Muret e xhamisë nuk janë shumë të larta, për dallim nga disa xhami të tjera në rajon. Kupola mbështetet në mure por vija e kurorës nuk është



*Pocitelj, Ibrahim Aga Mosque, 970H./1562*

*Pocitelj, Xhamia e Ibrahim Agës, 970H./1562*





horizontal. The transition elements are not visible from the exterior of the building yet the middle part of the facades are raised and thus the cornice line has an upward movement, following the central part of the wall. This kind of facade treatment was used by Architect Sinan and points to the more developed facade treatment of a single domed mosque.

The interior is nicely worked out with the squinch arches starting at a low level and forming an octagon to support the dome. The mihrab has classical features, while the minbar and mahfil (gallery level), window shutters and gypsum windows have been renovated in the 19th century. The drum is without any windows which is quite rare in monumental mosques. The case of Hadum Mosque can be explained by the status of the founder. A similar case is the mosque of Kasim Pasha, the deposed son of Sokollu Mehmet Pasha, in Havsva, near Edirne. The establishment is quite extensive in program but the mosque is small and the dome has no windows at its base.

As is common in many Balkan mosques, Hadum Mosque has a rather tall minaret in comparison with its size. The base of the minaret has a door opening to the porch. Access to the mahfil in the interior is provided by the lower part of the stairs leading to the balcony. This detail is common for many small and medium sized mosques in the Balkans.

#### **19th century repairs and decoration- addition of double arcades - some significant details**

The significance of the mosque derives partly from its rich colourful decoration which was added during a renovation in 1842. The entrance facade and the interior of Hadum Mosque are decorated with figures showing the mosque itself and representation of mosques with several minarets.

The porch was extended with the addition of an exterior enclosure in the nineteenth century. This was probably due to the demand for accommodation of more people during important religious festivities. Similar extensions were also made to the Karagozbej and Vucjakovic mosques in Mostar.

horizontale. Elementet e kalimit të trajtave nuk duken nga jashtë, por pjesa e mesme e fasadave është më e ngritur dhe për këtë arsye vija e kurorës është e pjerrët dhe e ngritur duke e përcjellë pjesën qendrore të murit. Ky lloj i trajtimit të fasadës është përdorur nga Arkitekt Sinani dhe tregon një trajtim më të zhvilluar të fasadës së xhamisë me një kupolë.

Enterieri është mirë i punuar me harqe me maje të cilat fillojnë në nivel të ulët dhe formojnë tetëkëndëshin në të cilin mbështetet kupola. Mihrabi ka tipare klasike, derisa minbari dhe mahfili (niveli i galerisë), qepenat e dritareve dhe dritaret e gipsit janë rinovuar në shekullin e XIX. Tamburi është pa dritare, gjë që është shumë e rrallë për xhamitë monumentale. Rasti i Xhamisë së Hadumit mund të shpjegohet me statusin e themeluesit. Një rast i ngjashëm është edhe xhamia e Kasim Pashës, djali të shkarkuar të Sokollu Mehmet Pashës, në Havsva, afër Edirnes. Kompleksi është shumë i gjerë sa i përket përmbajtjes, por xhamia është e vogël dhe kupola nuk ka dritare në timpan.

Si shumica e xhamive në Ballkan, minarja e Xhamisë së Hadumit është mjaft e gjatë në krahasim me madhësinë e vetë objektit. Baza e minares ka një derë e cila e lidhë atë me hajatin. Qasja në mahfil nga enterieri arrihet me pjesën e poshtme të shkallëve të cilat shpijnë në ballkon. Ky detaj është i zakonshëm për shumë xhami të vogla dhe të mesme në Ballkan.

#### **Riparimet dhe dekorimet e shekullit të XIX - shtimi i arkadave të dyfishta - disa detaje të rëndësishme**

Rëndësia e xhamisë pjesërisht lidhet me dekorimet e pasura dhe shumëngjyrëshe, të cilat u shtuan gjatë renovimit të vitit 1842. Fasada hyrëse dhe enterieri i Xhamisë së Hadumit janë të dekoruara me figura që ilustrojnë vetë xhaminë dhe xhamitë të tjera me shumë minare.

Hajati është zgjeruar me shtimin e një pjese të hapësirës së eksterierit në shekullin XIX: Kjo u bë, me siguri, për të përmbushur nevojën për pranimin e më shumë njerëzve gjatë festave të rëndësishme

The present minaret balcony probably dates from late Ottoman period. Instead of usual muqarnas corbelling, decorated stone courses form the support for the balcony floor. The decoration under the sherefe has tall small petal-like elements, which are similar to the sherefe of the Fatih Mosque in Prishtina. The parapet decoration also dates from the 19th century. The top of the minaret shaft had small arched panels carved into the shaft, which is a typical detail for minarets. But some holes were cut into this upper section, a detail which is not typical for Ottoman mosques. Analogical research in the region lead us to Peja Bayrakli Mosque, which has similar openings cut into the minaret shaft, probably intended to provide light to the stairs.

The 19th century decoration of the mosque is quite interesting. The floral decorations on walls and pilasters is in the form of a simplified Baroque, with fernlike vegetation in different colours painted on white and grey-blue background. Calligraphy complements the geometric and floral decoration which covers a great deal of the interior surfaces. Painting of landscapes appeared as a result of European influences in Ottoman architecture. Early examples of painted scenes survive in kiosks and palaces like Topkapi Palace. The representation of urban scenes became part of the decoration of civil architecture and it could be seen in the houses of the rich in western Anatolia and the Balkans. One late 18th century example from Greece, Ambelakia is well known.

The incorporation of urban scenes into religious architecture is later and some examples in Anatolia were studied in detail by art historians. R. Arik interprets this as the result of European influences in all ways of life. Her evaluation of such paintings is that they are a mixture of the miniature painting tradition in Ottoman manuscripts, mixed with European painting technique and styles. The quality of the paintings is not high but nevertheless they are original. The knowledge of perspective is missing. The scenes are still, with very little movement in them. People are not shown on these. They are usually idealized scenes and the subject is usually big cities like Istanbul, with details from the

fetare. Shtime të ngjashme janë bërë edhe në xhamitë Karagozbej dhe Vucjakovic në Mostar. Ballkoni - sherefeja ekzistuese e minares me siguri daton nga periudha e vonshme osmane. Dyshemeja e ballkonit mbështetet nga gurët e dekoruar e të lëshuar në formë anëcaku, në vend të anëcakëve të zakonshëm në formë të muqarnas. Dekorimi nën sherefe ka elemente të gjata në formë të petaleve, të cilat janë të ngjashme me sherefenë në Fatih Xhaminë në Prishtinë. Dekorimi i parapetit gjithashtu daton nga shekulli i XIX: Maja e trupit të minares ka pasur panele të vogla harkore të gdhendura në trupin e minares, që është detaj tipik për minaret. Por, në pjesën e sipërme janë hapur disa vrima, dhe kjo nuk është tipike për xhamitë osmane. Hulumtimi analog në rajon na shpiu në Bajrakli Xhaminë në Pejë, e cila ka hapje të ngjashme në trupin e minares, qëllimi i të cilave supozohet të jetë ndriçimi i shkallëve të minares.

Dekorimi i shekullit XIX i xhamisë është shumë interesant. Dekorimet bimore në mure dhe pilastra janë në formë të barokut të thjeshtuar, me vegetacion fieror të pikturuar me ngjyra të ndryshme në prapavijë të bardhë dhe të hirit në të kaltër. Kaligrafia plotëson dekorimet gjeometrike dhe bimore të cilat mbulojnë një pjesë të madhe të sipërfaqeve të brendshme.

Pikturimi i peizazheve u shfaq si rezultat i ndikimeve evropiane në arkitekturën osmane. Shembujt e hershëm të peizazheve të pikturuara kanë mbijetuar në kiosqet dhe pallatet si Pallati Topkapi. Përfaqësimi i peizazheve urbane u bë pjesë e dekorimeve në arkitekturën qytetare dhe mund të shihet në shtëpitë e të pasurve në Anadollinë perëndimore dhe Ballkan. Një shembull i njohur mirë i kësaj është në Greqi dhe daton nga fundi i shekullit XVIII.

Inkorporimi i skenave urbane në arkitekturën religjioze ndodh më vonë dhe disa shembuj në Anadoli janë studiuar detajisht nga historianët e artit. R. Arik e interpreton këtë si rezultat i ndikimeve evropiane në të gjitha sferat e jetës. Vlerësimi i saj i pikturave të këtylla është se ato janë një përzierje e traditës së pikturimit miniaturë në dorëshkrimet osmane, dhe teknikave e stileve

Bosphorus and the Golden Horn.

The painted decoration of Hadum Mosque is probably the work of a local artist who was familiar with such depictions and repeated the imagery of monumental mosque compositions in order to give this monument a touch of the new fashion in decoration.

The gypsum windows of the upper level are elegant details surviving from the late Ottoman period. Their design reflects Baroque style which can be compared to other buildings from late 18th to early 19th century in Turkey. The central part of some windows has a large panel surrounded by smaller areas carved into the gypsum frame. The outer windows of the upper level were totally missing, due to lack of maintenance.

It is interesting that, although there are no windows on the lower part of the dome, the 19th century painter placed them in their proper position while painting the dome.

The Hadum Mosque in Kosovo is a valuable treasure from the 16th century. It is a mosque preserving its basic classical Ottoman features; its 19th century renovation has an added value to this building with its spectacular decoration, unique in the Balkans. Similar decorations can be seen in other mosques in Kosovo; a similar mosque depiction is visible at the entrance of Fatih Mosque in Prishtina, the Bayrakli Mosque in Pec also has late Ottoman paintings, but the harmony of the architecture with the decoration and the selection of decorative themes makes Hadum Mosque more stand out among the others.

Prof. Dr. Zeynep Ahunbay

evropiane të pikturimit. Kualiteti i pikturave nuk është shumë i lartë, por sidoqoftë, ato janë origjinale. Njohuritë për perspektivën mungojnë. Skenat janë të qeta, me shumë pak lëvizje në to. Në të nuk figurojnë njerëzit. Zakonisht janë peizazhe të idealizuara dhe subjektet zakonisht janë qytetet e mëdha si Stambolli, me detaje nga Bosfori dhe Briu i Artë. Dekorimet e pikturuara në Xhaminë e Hadumit me siguri janë punë e ndonjë artisti vendor, i cili kishte njohuri për vizatime të këtilla dhe ka përsëritur imazhet e kompozicioneve të xhamive monumentale në mënyrë që këtij monumenti t'i jep një shenjë të modës së re në dekorim.

Dritaret nga gipsi në pjesën e sipërme janë detaje elegante që kanë mbijetuar nga periudha e vonë osmane. Dizajni i tyre reflekton stilin barok, i cili mund të krahasohet me objektet tjera nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX në Turqi. Pjesa qendrore e disa dritareve ka panel të madh të rrethuar me sipërfaqe më të vogla, të gdhendura në kornizën prej gipsi.

Dritaret e jashtme në pjesën e sipërme mungojnë plotësisht për shkak të mungesës së mirëmbajtjes. Është interesante që edhe pse nuk ka dritare në pjesën e poshtme të kupolës, piktori i shekullit të XIX i ka vendosur ato në vendin e duhur gjatë pikturimit të kupolës.

Xhamia e Hadumit në Kosovë është thesar i çmueshëm prej shekullit të XVI. Është një xhami e cila ruan tiparet bazike klasike osmane; renovimi i saj në shekullin e XIX ka shtuar vlerën e këtij objekti falë dekorimit të mahnitshëm, i cili është unik për Ballkanin. Dekorime të ngjashme mund të shihen edhe në xhamitë e tjera në Kosovë; Vizatimi i ngjashëm i xhamive shihet në hyrjen e Fatih Xhamisë në Prishtinë, derisa Bajrakli Xhamia në Pejë ka gjithashtu piktura të vonshme osmane, por harmonia e arkitekturës me dekorimet, dhe përzgjedhja e temave të dekorimit e bën që Xhamia e Hadumit të dallohet nga të gjitha të tjerat.

Prof. Dr. Zeynep Ahunbay





Prayer Hall

Salla e lutjeve

## HADUM MOSQUE - HISTORY, ARCHITECTURE, PAINTING AND STONEMWORK

The centuries-old rule of the Ottoman Empire in Albanian lands, and in Kosovo in particular, has left its traces in the material and spiritual culture of inhabitants of this region. The most widespread form of the visual arts was architecture, which left an undeniable mark in Kosovo's buildings. In Kosovo there is a considerable number of classic monumental mosques built mainly in XV, XVI, XVII centuries. One of such religious buildings is the Hadum Mosque in Gjakova, built in the last decade of XVI century, i.e. in 1594/95. Its building was financed by Hadum Sylejman Efendia - Hadum Aga, and thus the name of the mosque. The legend says that the mosque was built in the plain of Jakë Vula, from which the name of town, Jakova, derives. This dome-covered building belongs to the classic forms of mosques of the Islamic-Kosovar style.

### The architecture of Hadum Mosque

Hadum Mosque has a rectangular base, with a rectangular-base minaret erected from the southwestern wall. Its composition scheme is consisted of the following parts: the prayer hall, the vestibule - hajati in the northwestern façade and the minaret. It should also be noted that the mosque is surrounded by cemetery, in which gravestones are crafted with particular stonework, engraved and epigraphed in old Ottoman script. In olden times, members of known families of Gjakova were buried in this cemetery. This was common in other mosques elsewhere in Kosovo.

### The prayer hall

The prayer hall is made of one single volume and covered with a dome. This hall has a square plan and it can be entered into through the door in the north-western façade. The door has a slightly arched architrave. The hall is covered with a dome raising directly on pendentives on the corners of the bearing walls. The dome has a diameter of 13,50m, while the height from the floor to the ceiling is 12,60m. It is particularly worth noting that

## XHAMIA E HADUMIT - HISTORIKU, ARKITEKTURA, PIKTURA DHE PLASTIKA

Sundimi disa shekullor i Perandorisë osmane në trojet shqiptare e në Kosovë në veçanti u shpreh edhe në kulturën materiale dhe shpirtërore të banorëve të kësaj treve. Nga artet figurative më së shumti depërtoi arkitektura e cila la vullën kryesore në ndërtimtarinë e Kosovës. Në Kosovë kemi një numër të konsiderueshëm të xhamive klasike monumentale të realizuara në shek. XV, XVI, XVII dhe më pas. Një ndër këto objekte fetare është edhe Xhamia e Hadumit në Gjakovë e ndërtuar në dekadën e fundit të shekullit XVI, konkretisht në vitin 1594/95 Hadum Sylejman Efendia-Hadum Aga e ndërtoi xhaminë, e cila po ashtu edhe mban emrin e donatorit të objektit në Gjakovë. Xhamia sipas traditës, u ndërtua në fushën e Jakë Vulës nga edhe bëhet emërtimi i qytetit Jakovë. Kjo vepër e mbuluar me kube i takonë formave klasike të xhamive të grupit, të stilit islamo- kosovar.

### Arkitektura e xhamisë së Hadumit

Xhamia e Hadumit ka bazë katërkëndshe kënddrejtë me minare e cila del nga muri jug-perëndimor me bazë në formë kënddrejtë. Planimetria a skema kompozicionale e saj përbëhet nga këto pjesë: salla e lutjeve, hajati që zë vend në fasadën veri-perëndimore të veprës si dhe minarës. Po ashtu duhet cekur se për rreth xhamisë janë varret me nishane të realizuara në plastikë guri, të gravituara, të mbishkruara në gjuhë të vjetër osmane. Në të kaluarën në këtë pjesë të xhamisë u varrosen anëtarët e familjeve të njohura të Gjakovës. Kjo e cekur ishte karakteristike edhe për veprat, xhamitë e qyteteve të tjera kosovare.

### Salla e lutjeve

Salla e lutjeve ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kupolë. Kjo sallë ka planimetri katrorë në të hyhet nga dera e cila gjendet në fasadën veri-perëndimore. Dera është e mbuluar me arkitrav paksa harkor. Salla, me vëllimin e saj unik, është e mbuluar me kube të konstruktuar drejtpërdrejt mbi të nëpërmjet të trompeve në qoshet e mureve konstruktive. Madhësia, diametri i kubeut është 13.50



the dome is constructed on top of construction consisted of eight solid pilasters and pendentives. In addition, the drum of the dome does not have any openings, creating a so called "blind dome". The hall receives light from 11 windows.

Every side of the cube, except the north-western side where the entrance is located, has three windows. The north-western side over the portal has also a small arched opening. Windows, as constructive and architectural elements, are placed in two rows in shape of a triangle. The first row is symmetrical, featuring two windows in each façade of the building, i.e. in each of the four bearing walls. These windows are covered with architraves, but they also have blind tympanums that end in pointy arches.

The second row features only one window. This window, which is covered with pointy arch, is located directly under the drum, in all three façades of the building, with exception of the northern one. The windows of the first row in Hadum Mosque also have metal railings.

#### **Mihrab and mimber**

m. Ndërsa lartësia prej dyshemesë është 12. 60 m. Për këtë të cekur është specifike se kubeu qëndron në tetë pilastra të forta dhe në konstrukcion të trompeve. Duhet cekur se në këtë pjesë konstruktiv, në tamburin e xhamisë nuk kemi hapje a dritare, pra kemi të bëjmë me një kube të verbër. Sa i përketë ndriçimit salla e lutjeve merrë dritë nga gjithsejt 11 dritare. Çdo faqe e kubit, për dallim nga ajo veri-perendimore, ku ndodhet hyrja ka nga tri dritare. Edhe në këtë pjesë, mbi portal kemi një hapje të vogël gjysëm harkor. Dritaret si elemente konstruktive-arkitektonike janë të vendosura në dy rradhë, në formë piramidale. Në radhën e parë janë të konstruktura në mënyrë simetrike nga dy dritare në çdo faqe, përkatësisht në katër pamje të mureve konstruktive. Këto dritare janë të mbuluara me arkitra, por kanë edhe timpanone të verbërta që mbarojnë me harqe paksa të mprehta. Ndërkaq, në radhën e dytë ka të konstruktuar vetëm një dritare. Kjo dritare e mbuluar me hark të mprehtë ndodhet pikërisht nën tambur, në të tre muret anësore, pos asaj veriore. Dritaret e xhamisë së Hadumit, ato të rendit të parë, nga jashtë janë të siguruar me parmakë të metaltë.



*Mihrab and Mimber*

*Mihrabi dhe mimberi*

As every other mosque, the Hadum Mosque too features a mihrab opposite of the entrance. Mihrab is located in the center of the south-eastern wall and it is always oriented towards Mecca. This element is nicked into the wall forming a niche which ends in the upper part in form of a semi-cone. On the right hand side of mihrab is mimber, which is used for preaching. Mimler is consisted of: the door, the stairs and balldahin. Mimler has a traditional form and it is constructed entirely out of wood. All wooden elements are carved and painted in accordance with tectonic treatment of this element.

### **Mahfil / Gallery**

Mahfil, too, is constructed entirely of wood, and it is supported by profiled wooden columns. Mahfil or the gallery, as a constructive, architectural and functional part of the mosque, enriches and breaks the monotony of the volume of prayer hall. It has plastic and painted decorations. The gallery is placed on the north-western side of the mosque, over the entrance into the prayer hall and it stretches along all of its width. It is supported by the north-western wall, as well as, wooden columns. Mahfil is accessed through minaret staircase. Similar to other parts of the mosque, mahfil, too, is painted with floral motifs.

### **Constructive elements - pendentives**

### **Mihrabi dhe mimberi**

Si në çdo xhami edhe në këtë të Hadumit përballë hyrjes është mihrabi. Mihrabi gjendet në mesin e murit jug-lindor dhe përherë është i orientuar në drejtim të Mekës. Ky element është i thelluar në mur në formë nike me pjesën e sipërme gjysmë konike. Pos mihrabit këtu në të djathtë të tij është mimberi që shërben për predikim. Mimleri përbëhet prej: derës, shkallëve dhe balldahinit. Pra si shifet mimberi ka formë tradicionale të trajtave të mimberëve dhe është e punuar në tërësi nga druri. Të tëra elementet e drurit janë të gdhendura dhe të pikturuara në atë mënyrë që i përgjigjen trajtimit tektonik të këtij elementi.

### **Mahfili**

Të tëra nga druri është realizuar edhe mahfili, i cili qëndron mbi shtyllat, kolonat e profilizuar të drurit. Mahfili a galeria si pjesë konstruktive-arkitektonike e funksionale pos që e pasuron dhe thënë monotoni e volumit të sallës së faljeve veçohet edhe me dekoracione plastike e pikturale. Galeria zë vend në anën veri-perendimore mbi hyrjen në sallën e lutjeve, në tërë gjërësinë e saj. Pos që mbështetet për murin veri-perendimor ajo qëndron edhe mbi kolona, shtylla të drurit. Në mahfil arrihet nëpërmjet shkallëve të minarës. Si pjesët tjera të xhamisë edhe mahfili është i tërë i pikturuar, natyrisht me motive të botës bimore.

*Mahfil / Gallery*

*Mahfili*





مَعْرُوفٌ  
لِأَبِي عَبْدِ اللَّهِ  
بِأَنَّكَ  
بِأَنَّكَ

*Detail of decorated pendants*

*Detal i dekorimit të trompeve*

The main outer volume of the mosque is consisted of the cubic part and the dome. The exterior of the mosque is constructed of hewn stones. Stones are taken from a quarry in the vicinity of Gjakova, close to Erenik, between Deva and Guske village. The interior walls of the mosque are covered with bricks and plaster. In order to construct the dome of the mosque, the cubic volume of the walls has been transformed into an octagon. During this process, in the four corners of the volume pendentives are created in shape of quarter-spherical vaults. On the two outer sides, they end in cornice and are covered in lead. The constructive part, which starts from the volume of the mosque, respectively from the pendentives, continues up to the cornice, where it forms the drum, as a constructive and architectural element. The drum of the Hadum mosque is rather low in height and of octagonal shape. Unlike other parts of this sacral building, the pendentives and the dome have been constructed in bricks. The lead cover of the dome of the mosque begins from the cornice.

**The portico - hayat of the mosque**

### **Elementet konstruktive, trompet**

Vëllimi i jashtëm kryesor me kube përbehet nga pjesa kubike dhe kubeu. Vëllimi kryesor nga ana e jashtme është mbështjellur, konstruktuar nga gurët e latuar. Gurët janë marrë në afërsi të Gjakovës, matanë Erenikut, në mes të Devës dhe fshatit Guskë. Ndërkaq faqet e brenshme të mureve janë me tulla dhe të suvatuara. Për të realizuar, konstruktuar kubën e xhamisë nga vëllimi i kubit është kaluar në tetëkëndësh. Në rastin konkret, gjatë këtij procesi të ngushtimit, në katër qoshet, skajet, formohen trajtat e çerek topit-trompet të cilat në të dy anët e jashme mbarojnë në kurorë dhe janë të veshura me plumb. Pjesa konstruktive, e cila fillon nga vëllimi, përkatësisht nga trompet e vazhdon, përfundon në kurorë, ku fillon kalota e xhamisë na paraqet tamburin si element konstruktive-arkitektonike. Tamburi në xhaminë e Hadumit është e ulët dhe tetë faqëshe. Për dallim nga pjesët të tjera të objektit sakral, trompet dhe në tërësi kubeu i xhamisë është konstruktuar, muratuar me tulla të pjekura. Nga kurora e tamburit fillon mbulesa me plumb e kubesë së objektit në fjalë.



*Detail of interior decorations  
Detal i dekorimit të enterierit*





*The vestibule of Hadum Mosque*

*Hajati i Xhamisë së Hadumit*



The portico or the porch of the Hadum Mosque is located on the north-western façade and is of traditional shape, common in classical and monumental buildings of this type not only in Kosovo and other Albanian lands, but also all over Balkans. The portico is also used for prayer rituals. It is covered with three small domes. These domes, same as the main one, are covered with lead.

The portico is accessed directly from outside. The middle part of the vestibule is on the same level with the prayer hall. This part divides the vestibule into two equal sections and it serves as an entrance into the prayer hall. The portico floor (in both sections), as usual, is on a higher level than the floor in the prayer hall and the ground level. Originally, the portico floor was covered with hexagonal terracotta slabs, identical to the ones used in the interior floor of the prayer hall. So, as it can be seen, the floor of the mosque portico is used as a podium and a base for its column arcades.

#### **Portico arcades**

The north-western arcade, i.e. the one on the frontal façade of the Hadum Mosque, is consisted of three semicircular arches that are supported by four columns. The columns of the mosque's portico are not monolithic, but rather constructed of three sections of massive stones. The columns do not have bases, which is uncommon in the architecture of the Ottoman period in Kosovo. In addition, column capitals are quite modest. The bases and capitals of the columns feature brass rings as decorative elements. The eastern and western side feature only single arches supported by the northern arcade columns and the bearing walls of the mosque.

#### **The minaret**

Minaret is a key element of the compositional scheme of a mosque, and it is usually located on the right hand side of the prayer hall, extruding from the south-western wall. The minaret is accessed through two small doors. One of them is placed in the interior of the mosque, the other in the exterior. The exterior door is smaller than the other one and it is on the same level with the floor of the prayer hall, whilst the interior door to the minaret is constructed on the level of mahfil floor.

#### **Hajati i xhamisë**

Tremi a hajati i xhamisë së Hadumit përfshinë pamjen veri-perendimor dhe ka një zgjidhje tradicionale të këtyre mjediseve të veprave klasike monumentale jo vetëm në Kosovë dhe pjesë të tjera shqiptare, por edhe për Ballkanin. Mjedisi në fjalë shërben për lutje, falje të namazit. Hajati mbulohet me tri kube të madhësisë së vogël. Këto kube si dhe ajo kryesorja janë të veshura me mbulesa të plumbit.

Nga jashtë në hajat hyhet drejtpërdrejt. Pjesa ndër-mjetëse e hajatit është në nivel të sallës së lutjeve. Nga kjo pjesë të hajatit, e cilia e ndanë në dy mjedisa të barabarta mjedisin në fjalë, hyhet në sallën e lutjeve. Dyshemeja e hajatit ( në të dy anët e ndërmjetëses) si për herë është në nivel më të lartë nga dyshemeja e sallës së lutjeve dhe të terrenit pranë xhamisë së Hadumit. Edhe dushemeja e hajatit në kohë ishte e shtruar me pllaka prej tullash (dheu i pjekur) gjashtëkëndëshe, dhe ishin identike me dyshemenë e enterierit, sallës së faljeve. Pra siq shihet dyshemeja e hajatit të xhamisë paraqitet si një podium dhe kështu shërben si bazament ndaj arkadave mbi shtylla, kolona të mjedisit në fjalë.

#### **Arkada e hajatit**

Arkada veri-perendimore, pra e ballit kryesor të xhamisë së Hadumit, përbehet prej tri harqesh gjysmërrethore që mbështeten në katër shtylla, kolona. Kolonat e hajatit të xhamisë nuk janë monolite, por të konstruara nga disa pjesë, përkatësisht nga tri pjesësh të gurëve masiv. Kolonat nuk kanë bazament dhe paraqesin një gjë të rastit në arkitekturën të periudhës osmane në Kosovë. Po ashtu edhe kapitelet e shtyllave janë tejet modeste. Në bazamentin e shtyllave si dhe para kapiteleve të tyre si pjesë dekoruese na paraqiten unazat e materialit të misingut. Nga ana lindore dhe perendimore kemi vetëm nga një hark të mbështetur në kolonën e arkadës veriore dhe murit konstruktiv të pamjes kryesore të objektit sakral.

#### **Minareja**

Si pjesë e skemës kompozicionale, si element i pandarë i xhamisë është edhe minareja, e cila si zakonisht zë vend në të djathtë të sallës së faljeve duke



*The Minaret*

---

*Manarja*

The latter is used to access the minaret from mahfil, or vice versa.

The minaret has a rectangular base which rises in shape of a flat pyramid and ends in a stone cornice that is detached from the perimeter wall. From this point upwards, the minaret's shaft is constructed in a polygonal shape. The shaft of minaret narrows up to the second cornice. From the second to the third cornice, the minaret becomes slightly narrower. The polygonal shaft of the minaret ends in the so-called minaret sherefe (drum). Sherefe is constructed from several rows of stones consoled from the perimeter walls as to form a balcony, which provides sufficient moving space for the priest - hoxha to move during a religious rite, such is calling the worshipers for prayer - ezan.

The parapet of the balcony is carved in relief with detailed stonework. The balcony is accessed through a small and narrow door. The minaret construction continues with the upper part - the petek of minaret. Petek ends with a conical roof, the so-called qylah. Qylah is of wooden construction and it is covered with lead. The top of minaret's roof features a decorative and final element, with high artistic and aesthetical values, the alem of minaret. Same decoration elements are present in the dome of the prayer hall of the Hadum Mosque in Gjakova.

One of the main functions of minaret is to enable access to the balcony - sherefe through its staircase. The staircase is constructed of monolith stones that are also a part of the minaret wall construction and which are constructed continually on top of one-another up to the sherefe door. The interior of the minaret is lightened by a small number of window openings. These openings have the shape of embrasures and, besides providing the above-mentioned function, they also serve for ventilation of the minaret.

#### **Mural decorations - arabesques**

Hadum Mosque, as well as other dome-covered monumental buildings of this type built in XV, XVI and XVII centuries elsewhere in Kosovo, features paintings - mural decorations that have been exten-

dal nga muri jug-perendimor. Me minare komunikohet me ndihmën e dy deriçkave, dyerve të vogëla. Njëra është në eksterier kurse tjetra në enterier të objektit. Deriçka e eksterierit të minares ka një madhësi të vogël dhe është në nivel të dyshemes së sallës së lutjeve. Ndërsa deriçka tjetër e minares është e konstruktuar në nivel të dyshemes së mafilit. Nga minareja nëpërmjet deriçkës së cekur komunikohet me mafilin dhe anasjelltas me minarën.

Baza e minarës ka planimetri, bazament të këndëdrejtë që vazhdon me papuqen në formë të piramidës së cinguar duke përfunduar me një kornizë guri që del nga muri perimetral i elementit konstruktiv. Nga kjo pjesë fillon trupi i minarës që ka formë shumë këndore a poligonale. Trupi i minarës nga korniza e parë shkon duke u ngushtuar deri në kornizën e dytë. Prej lartësisë së kornizës së dytë, trupi i minarës gjithëherë, lehtësi, duke u ngushtuar mbaron me kornizën e tretë. Këtu trupi poligonal përfundon me kazanin a sherefen e minarës. Sherefeja në lëshime anëcake nga disa rende gurësh të latuar del nga muri poligonal perimetral të trupit të minarës dhe kështu merr, fiton një gjërësi sa për të lëvizur në rast nevoje, për kryerjen e ndonjë ceromonie të caktuar fetar: thirja e ezanit për tenbih etj.

Kazani ka edhe parapetën e tij. Kjo pjesë, pra sherefeja në xhaminë e Hadumit paraqet një pjesë ku prezantohen gdhendje në teknikën e relievit, në plastikë të imët. Daljen në kazan na bënë të mundur një deriçkë e ngushtë dhe e ulët. Konstruksioni i minarës nuk mbaron me kaq, por tani mbi kazan vazhdon pjesa e sipërme, peteku i minarës. Peteku mbaron me pjesën konike të qyajtur qylah. Qylahu ka konstrukcion druri dhe është e mbuluar e veshur me mbulesë të plumbit. Në fund të minarë si element përfundimtar, njëherit, edhe element dekoracioni me cilësi artistike e estetike është edhe alemi i minarës. Elementi të njëjta dekoracioni na prezantohen edhe kubën e sallës së faljeve të xhamisë së Hadumit në Gjakovë.

Pos tjerash funksioni i minarës është që nëpërmjet të shkallëve të saja të arrihet në kazan-sherefe. Shkallët janë nga gurët njëpjesësh të vendosura,

*Arabesques on the main dome*

*Arabeskat në kubenë kryesore*





sively used to adorn the walls of Islamic-Albanian sacral buildings.

The interior of the domes covering the portico is decorated with murals painted in secco technique. The main motifs are stylized landscapes (in some cases with motifs of vernacular architecture, of kullas of Dukagin plain) with cypress trees, still nature, stars, motifs of architectural religious buildings - mosques, floral ornaments, geometrical figures and quotations for Kur'an. Even though these decorations are repeated, they are not monotonous, but only enrich the values of the building itself. These motifs, used for decoration in Islamic art, are known as wall paintings or arabesques.

Such decorations are found on the main dome as well as in the mosque's porch, cornice, niche, arches and pendentives. One must also note that mihrab, mimber, mahfil and parts of prayer hall walls around the windows are decorated with murals. Dominating colors in these decorations are: red, blue, green, ochre, grey and black, the latter being used in the Kur'an quotations and written names of Allah, Mohammed and his descendants. These decorations belong to the Islamic-Albanian baroque of the XIX century.

Hadum Mosque has three layers of wall paintings. Existence of these layers was determined during conservation-restoration works in year 1981. Surveys conducted on the middle dome of the portico revealed three layers of paintings. On the other hand, side domes have only two layers with decoration. The motifs in discovered layers are mainly floral and geometric shapes, dominated by auburn and black colors. These motifs and colors characterize also the second layer of decorations. It is assumed that the first two layers of painting date back to XVII-XVIII centuries, while the third, existing layer was painted in year 1260 (according to hijr), respectively in year 1844. This date is also confirmed by the inscription and the date on the tympanum of the main portal.

konstruktura edhe si pjesë të pa ndarë të mureve konstruktive të minarës që vazhdojnë njëra pas tjetrës në kontinuitet deri në deriçkën e sherefes. Enterieri i minarës në xhaminë e Hadumit ndriçohet nga një numër i vogël hapjesh, dritarësh. Këto hapje kanë formë të frengjisë. Hapjet të zënë n'gojë pos funksionit të cekur luajnë edhe rolin e ajrosjes së minarës.

### **Dekoracionet murale-arabeskat**

Në xhaminë e Hadumit, në veprën monumentale të mbuluar me kube si dhe në disa vepra të tjera të karakterit dhe tipit të cekur në Kosovën të ndërtuara në shek. XV, XVI e XVII na prezantohen edhe pikturat, dekoracionet murale të cilat me ekzistencën dhe pamjet e tyre zbukurorin muret e objekteve sakrale islamo-shqiptare. Këso dekoracione kemi edhe në hapësirat, sipërfaqet e mureve të xhamisë së Hadumit në Gjakovë.

Enterieri, pamja kryesore e xhamisë, kubet e hakatit janë të dekoruara me pikturë murale të punura në seko teknikë. Motivet kryesore janë peisazhet e stilizuara (në disa raste e dhe me motive të arkitekturës popullore, kullave të rrafshit të Dukagjinit) me selvi, natyra të qeta, yjet bosh, motive arkitektonike të objekteve të kultit-xhamit, ornamente të botës bimore, figura gjeometrike dhe citate të Kuranit. Edhe pse dekoracionet përsëritën ato nuk janë monotone, por me prezencën dhe pamjet e tyre ia risn vlerën e objektit. Këto motive të prezantuara me përmbajtje të dekoracionit të tyre në artin e Islamit njihen si piktura murale a arabeska.

Dekorimet e cekura, paraqiten në kubeu kryesor si dhe ato në hajatin e objektit, në kurorë, nike, harqe dhe trompe. Njëherit duhet cekur se edhe mihrabi, mimberi, mahfili, pjesët e mureve të sallës së lutjeve për rreth dritareve në veçanti janë të dekoruara me piktura murale. Ngjura dominuese në këto dekoracione janë: e kuqja, e kaltëra, e gjelbëra, oker, e përhimtja e zeza e cila përdorët vetëm në citatet e kuranit si dhe në emërin i Allahut, Muhamedit si dhe pasardhësve të tij. Dekorimet e cekura i takojnë stilit të barokos islamo-shqiptar të realizuara në shek.XIX.

### **Stonework**

Similar to other domed monumental buildings of Kosovar heritage, the Hadum Mosque too has modest stonework. The stonework in this sacral building of Islam-Albanian architecture can be found in forms of stalactites, mainly crafted on the parapet of the minaret balcony. These decorations have been realized in the detailed stonework technique. The portico columns do not have plastic decorations, but their square capitols feature stylized flowers crafted in detailed stone masonry. The same decoration is featured on all four columns of the porch. Windows, the main portal, cornices of the prayer hall, portico and the parapet of the minaret balcony are also profiled. Generally speaking, the walls as well as other architectural and constructive elements are clean and modest, which is characteristic for the architecture of this mosque in Gjakova, as well as in other Albanian territories.

Në xhaminë e Hadumit kemi tri shtresa pikturale. Ekzistimi i shtresave në dekorimet pikturale është konstatua gjatë punëve konservuese-restauruese të vitit 1981. Me këtë rast, në bazë të sondimeve të bëra në kubet e mesëm të hajatit u verejtë tri shtresa të pikturimit. Ndërsa në kubet anësore kemi nga dy shresa të dekorimit. Motivet në shtresat e gjetura janë nga bota bimore dhe figura gjeometrike ku dominon ngjyra e kuqe qeramidhe dhe e zeza. Motivet si dhe ngjyrat e cekura janë karakteristike edhe për dekoracionet e shtresë së dytë. Dy shtresat e para duhet të takojnë shek. XVII-XVIII. Shtresa e tretë dekoruese kjo ekzistuesja është sendërtua në vitin 1260 (sipas hixhrit), përkatësisht në vitin 1844. Këtë të dhënë e dokumenton mbishkrimi dhe data e shënuar në timpanonin e portaltit kryesor.

### **Plastika gurore**

Si veprat të tjera monumentale të mbuluara me kube të trashigimisë kosovare edhe xhamia



*Stone work on minaret balcony*

*Detaj i pëpunimit të shrefesë*

It should also be noted that the mosque's domes, which vary in size, add dynamics and contrast to the building, thus improving its aesthetical appearance.

Finally, one can conclude that the Hadum Mosque with its proportions, forms and features, carries in itself something powerful that radiates and gives warmth to the building itself, which is coordinated and fits perfectly, even nowadays, in the ambiance of the Çarshia e Madhe in Gjakova.

**Dr. Fejaz Drançolli**

Hadumit nuk është e pasur me plastikë gurore. Plastika gurore në këtë vepër sakral të ndërtimitarisë islamo-shqiptar na prezantohet si stalaktite kryesisht në parapetën e shrefes së minarës. Këto dekoracione janë të realizuara në teknikën e plastikës së imët. Edhe shtullat e hajatit nuk kanë dekoracione plastike, por paksa veçohen me kapitelin në formë katrore ku na prezantohen lulet e stilizuara të realizuara në teknikën e plastikës së imët. Këto dekoracione përseritën në katër shtylla të hajatit. Me profilizime cilësohen edhe dritarët, portali kryesor, kurorat e sallës së lutjeve, të hajatit si dhe vet parapeta e minarës së xhamisë. Pra në përgjithësi sipërfaqet e mureve si dhe elementet arkitektoniko-konstruktive janë të pastëra dhe modeste e që kjo është karakteristike për arkitekturën e xhamisë në Gjakovë dhe më gjërë në territoret shqiptare. Poashtu duhet të theksojmë se kubet e xhamisë me madhësi të ndryshme dhe ato me dinamikë dhe kontrast ndikojnë në thyerjen e monotonisë së objektit dhe japin pamjen estetike të xhamisë.

Pos tjerash mund të konkludojmë se xhamia e Hadumit me proporcionet, format dhe trajtat e saja, përmban në vete diçka të fuqishme, e cila gjë ndikon dhe jep një ngohtësi objektit i cili në tërësi është kordinuar dhe jeton edhe sot e gjithë ditën në ambientin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë.

**Dr. Fejaz Drançolli**





## DOCUMENTATION PHASE

Restoration works in Hadum Mosque started with the documentation phase. This phase includes all activities necessary to carry out a study and gather information on historical data and facts, photos and drawings from other books, different writings and archives. Fortunately, all these data were found in respective institutions, responsible for preserving them, and in private archives of citizens.

Bearing in mind that the Mosque itself is the best and most valuable source of information, necessary measurements of the whole building and important details were taken with the greatest care. One must note that this was the first time in Kosovo that such a documentation process has been carried out, involving experienced experts from Turkey and Egypt, who were engaged in completing the documentation, measurements and needed analysis, by using the most modern equipment. All damages have been documented, together with the different materials used in the building, including plasters and mortars used, types of stones in the façade as well as the remains from the destroyed minaret, in order to determine all their characteristics and material components and their technical performances.

### Description of building materials

#### The Portico

The portico columns and capitols are built of marble stone with relatively large pores. The edges of the portico parapet are constructed of limestone, while the column bases are made of marble stone, identical to the ones used for the columns. The portico floor is paved with terracotta slabs.

#### The Dome

The dome is one of the most important constructions of the mosque. This constructive element is a half sphere with a diameter of 11,60 meters, and it is built over the tromps (pendentives) that start on a height of +7,12m and end on +12,82m. Its shell is 60cm thick and it is built from radial terracotta bricks specially-made for this construction. The bricks are joined with lime mortar, while the dome is covered with lead sheets. Under the cover there

## FAZA E DOKUMENTIMIT

Punët e restaurimit të Xhamisë së Hadumit kanë filluar me fazën e dokumentimit. Kjo fazë përfshin të gjitha aktivitetet e nevojshme për studimin dhe mbledhjen e të dhënave dhe fakteve historike, fotografive dhe vizatimeve prej librave të tjerë, shënimeve të ndryshme dhe arkivave. Fatmirësisht, të gjitha këto informata i kemi gjetur në institucionet përkatëse që bëjnë ruajtjen e këtyre të dhënave, si dhe arkivat private të qytetarëve. Duke pasur parasysh faktin se vetë Xhamia është burimi më i mirë dhe më i vlefshëm i informatave, me kujdesin më të madh kemi kryer matjet e duhura të të gjithë objektit dhe detajeve të rëndësishme. Duhet të theksohet se ky proces i dokumentimit u realizua për herë të parë në Kosovë me përfshirjen e ekspertëve nga Turqia dhe Egjipti, të cilët i kryen dokumentimin, matjet dhe analizat e duhura duke përdorur pajisjet më moderne. Janë dokumentuar të gjitha dëmtimet dhe materialet e ndryshme të përdorura, duke filluar nga suvatë dhe llaçërat e përdorura, llojet e gurëve të fasadës dhe copëzat e mbetura nga minarja e rrënuar, në mënyrë që të shqyrtohen të gjitha karakteristikat e tyre e të gjithë komponentëve të materialeve të ndryshme dhe performancave teknike të tyre.

### Përshkrimi i materialeve ndërtimore

#### Portiku

Shtyllat dhe kapitelet e portikut janë të ndërtuara prej gurit të mermerit me pore mjaft të mëdha. Skajet e parapetit të portikut janë të ndërtuara prej



*Paving of portico floor*

*Shtruarja e dyshemesë së portikut*

is a layer of mud mixed with goat hair; this layer uses as amortisation and isolation between the brick construction and cover from lead sheets.

### The Minaret

The minaret was constructed from three types of stone.

The base of the minaret, up to the first ring was constructed from sedimentary stones ("conglomerate"). The minaret shaft was constructed of two types of limestone. The lower half of the minaret shaft was built from a softer limestone, which is more vulnerable to humidity and as such, it has suffered greater damages. The upper half of the minaret shaft, up to the minaret balcony was built of more porous limestone, yet more durable and resistant to humidity, thus it had fewer damages. The minaret balcony is built of two types of limestone: soft and hard.

### Frames of windows and minaret door

Windows and minaret door frames are built from softer limestone, similar to the one used for the lower shaft of the minaret.

At right window on the western facade, on the

gurëve gëlqeror, kurse bazat e shtyllave janë të punuara prej gurit të mermerit, identik me atë të shtyllave.


Dyshemeja e portikut është e shtruar me pllaka të argjilës.

### Kupola

Kupola është një nga konstruksionet më të rëndësishme të xhamisë. Ky element konstruktiv është një gjysmësferë me diametër prej 11,60 metrave, dhe është e ndërtuar mbi trompe që fillojnë në lartësi prej +7,12 metrave dhe përfundojnë në +12,82 metra. Kupola ka një trashësi prej 60 cm dhe është e punuar nga tulla radiale nga argjila e pjekur, të punuara posaçërisht për këtë konstruksion. Tullat janë të lidhura me llaç gëlqeror, kurse vetë kupola është e mbuluar me shtresë plumbi. Nën mbulesën prej plumbi është e vendosur shtresa e baltës së dheut të përzier me qime dhie, e cila shërben si amortizim dhe izolim mes konstruksionit të tullave dhe mbulesës së plumbit.


### Minarja

Minarja është ndërtuar prej tri llojeve të gurit. Baza e minares deri te unaza e parë është ndërtuar me gurë të sedimentuar - konglomerat. Trupi i minares është ndërtuar prej dy llojeve të gurëve gëlqeror. Gjysma e poshtme e trupit të minares është ndërtuar prej gurit gëlqeror më të butë në të cilin lagështia depërton më lehtë dhe ka dëmtime



The Minaret

Minarja



A column capitol

Kapiteli i shtyllës

upper part of the window, heavier sandstones were inserted during past interventions and they were bound with cement mortar.

### **The façades**

The walls and dome drum are built of sedimentary stones, which is a rather strong material. In some places where stones have been replaced during previous interventions, dark grey sandstone has been used, even though it is softer than the original stone.

### **Mortar**

Originally, lime mortar was used to bind construction stones of the building. However, in later works, cement mortar has been used for infill of joints and missing parts, as well as for binding of replaced stones.

më të mëdha. Gjysma e epërme e minares, deri te sherefeja, është e ndërtuar prej gurëve gëlqeror më poroz por më të fortë, ku lagështia nuk depërton shumë, prandaj këtu ka pasur më pak dëmtime të gurëve.

Sherefeja është ndërtuar prej të dy llojeve të gurëve gëlqeror, të butë dhe të fortë.

### **Kornizat e dritareve dhe korniza e derës së minares**

Kornizat e dritareve dhe korniza e derës së minares janë prej gurit gëlqeror të butë, të ngjashëm me atë të përdorur në pjesën e poshtme të minares.

Në pjesën e sipërme të dritares së djathtë në fasadën perëndimore, janë vendosur gurë zallorë me peshë të madhe gjatë intervenimeve të mëparshme dhe janë murosur me llaç çimentoje.

### **Fasadat**

Muret dhe tamburi i kupolës janë të ndërtuara prej gurëve të sedimentuar - konglomerat, që janë material mjaft i fortë. Në disa vende ku gurët janë zëvendësuar gjatë intervenimeve të mëparshme, janë përdorur gurë zallorë ngjyrë hiri, që është më i dobët se guri original.

### **Llaçi**

Llaçi original i përdorur është llaç gëlqeror. Por, në punët e mëvonshme, është përdorur llaçi i çimentos për fuga, mbushjen e pjesëve që kanë munguar dhe për murosjen e gurëve të zëvendësuar.


*Façade stones*

*Gurët e fasadës*









■ Limestone 1	■ Limestone 2	■ Brick
■ Limestone 3	■ Limestone 4	■ Bitum
■ Sandstone	■ Conglomerate	■ Brick
■ Stone	■ Marble	■ Limestone rubble masonry
■ Gypsum	■ Shale	


documentation project  
material analysis

BACK FACADE

Location: Municipality of Gökova  
Architect: Mustafa Pekirkömüç

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE





Light steel	Limestone 2	Iron
Limestone	Limestone 1	Brick
Sandstone	Concrete	Brick
Stone	Marble	City wall brick (Kaya)
Cement	Brick	


documentation project  
material analysis

LEFT FACADE

Location: Municipality of Gjakova  
Architect: Mustafa Pelicorogjic

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE





- |              |              |                       |
|--------------|--------------|-----------------------|
| Limestone 1  | Limestone 2  | Brick                 |
| Limestone 3  | Limestone 4  | Brick 2               |
| Sarcophagite | Conglomerate | Brick 3               |
| Stone        | Marble       | Clay with small holes |
| Cement       | Brick 4      |                       |

documentation project  
material analysis  
**RIGHT FACADE**  
Ispahsaray Municipality of Gjakova  
architect: Mustafa Pelibramçija

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE



## Description of damages

### The dome

During the bombing and destroying of upper part of minaret, the dome was damaged from fallen stones. Damages were evident on the cover of lead sheets, which were cut and split. But most of the damages came from the water that leaked inside the brick construction. After the analysis of existing lead sheet, by the supervisor Professor Z.Ahunbay, it was stated that the existing cover had lost its ability, and it should be replaced with a new one.

### The portico

The Mosque's portico has four columns. All four columns had large cracks along their shafts. Column cover plaster was missing in part, while in some places it was detached from the stone. The stones in column capitols were cracked. The second column from the left was the most damaged one and this was caused by a direct hit from a vehicle. The marble stones on the base of the column did not have any major damages, while the edges of portico floor, constructed of limestone, were quite eroded.



*Damages on portico column*

*Dëmet në shtyllën e hajatit*

## Përshkrimi i dëmtimeve

### Kupola

Gjatë granatimit dhe shkatërrimit të petekut të minares, kupola është dëmtuar nga gurët e rëna. Dëmet ishin të dukshme në mbulesën e plumbit, e cila ishte e çarë dhe e shqyer. Por, shumica e dëmtimeve kanë ndodhur nga uji i cili ka rrjedhur brenda konstruksionit të tullave. Pas analizës së mbulesës ekzistuese të plumbit, nga mbikëqyrësi profesor Z. Ahunbay, u konstatua se mbulesa ekzistuese kishte humbur aftësinë e saj dhe se duhej të zëvendësohej.

### Portiku

Portiku i xhamisë ka katër shtylla. Që të katër shtyllat kishin të çara të mëdha në trupin e tyre. Suvaja e në të gjitha shtyllat mungonte vende-vende, kurse në disa raste ishte e çuar nga gurët. Gurët në kapitelet e shtyllave ishin të çara. Shtylla e dytë nga ana e majtë ishte më e dëmtuar për shkak të një goditje të drejtpërdrejtë nga një automjet. Gurët e mermerit në bazat e shtyllave nuk kanë pësuar ndonjë dëmtim të madh, kurse skajet e dyshemesë së portikut, të punuara nga guri gëlqeror, ishin shumë të gërryer.

*Damages on lead cover of the dome*

*Dëmet në plumbin e kupollës*





### The minaret

The upper part of the minaret, above the balcony ("sherefë"), was shelled by Serb forces during the 1999 war. Fragments from this part fell over the old library building and destroyed it badly.

As the minaret was constructed of three different types of stones, the damages varied in different parts of the minaret. The most damaged part was the middle of the minaret, and the lower part of the balcony, since they were constructed from soft limestone. The surface of these stones was eroded; some of the stones were missing while the others were cracked. The lower part of the balcony, in some parts, had a black crust on the surface of the stones.

In addition, during the war, the minaret was damaged by a shell, which created a hole in the shaft of the minaret.

Furthermore, past interventions with cement mortar and plaster have caused great damages to the stones.



### Minarja

Pjesa e epërme e minares, prej sherefesë dhe e lartë, ishte granatuar nga forcat serbe gjatë luftës së vitit 1999. Copa nga kjo pjesë kanë rënë mbi objektin e bibliotekës së vjetër dhe e shkatërruan tërësisht.

Meqenëse minarja është e ndërtuar nga tri lloje të gurëve, dëmtimet kanë qenë të ndryshme në pjesët e ndryshme të minares. Pjesa më e dëmtuar e minares ishte pjesa e mesme dhe pjesa e poshtme e sherefesë, pasi që ishin të punuara nga guri gëlqeror i butë. Sipërfaqja e këtyre gurëve ka qenë e lëvorosur, disa nga gurët kanë munguar kurse të tjerët ishin të çarë. Në disa vende, pjesa e poshtme e sherefesë e ka pasur edhe një shtresë të zezë. Krahas këtyre dëmeve, një granatë e hedhur gjatë luftës ka dëmtuar minaren duke krijuar një vrimë në trupin e saj.

Përfundimisht, edhe intervenimet e mëparshme me llaç të çimentos u kanë shkaktuar gurëve dëme të mëdha.

### Kornizat e dritareve dhe korniza e derës së minares

Gurët e dritares së majtë dhe djathtë në fasadën perëndimore, kanë pësuar dëmtime të mëdha. Këta gurë kanë pasur çarje, lëvorosje të mëdha dhe myshqe, kurse disa nga gurët e dëmtuar shumë edhe kishin rënë. Gjysma e gurit horizontal të poshtëm të dritares së djathtë në fasadën perëndimore ka qenë e mbushur me llaç të çimentos në një rën nga intervenimet e mëparshme.

Dritaret e tjera kanë pasur çarje, myshqe në sipërfaqet e gurëve, zëvendësime me gurë joadekuat dhe rrëshqitje të gurëve horizontal përmbi dritare për shkak të peshës së madhe të gurëve përsipër.

*Damages on minaret's upper part*

*Dëmet në pjesën e sipërme të minares*



*Cement mortar fillings on the upper window frame and iron shutters that were later replaced with white cement grids*

*Mbushjet me llaq çimentoje në kornizën e njëjës nga dritare e sipërme dhe grilat e hekurit të cialt janë zëvendësuar me grila çimentoje të bardhë*

### Frames of windows and minaret door

Stones of the right and left window on the western façade suffered large damages. They were cracked, covered with moss and badly eroded, while some of the badly damaged stones had even fallen off. Half of the lower horizontal stone of the right window on the western facade was filled with cement mortar during one of the past interventions.

Other windows had cracks, moss on upper surface of the stones, parts replaced with inadequate stones and sliding of horizontal stones over the windows, caused by the heavy weight of the top stones.

**The frame of minaret door** - The stone over the minaret door was cracked along its sides. It was eroded and covered with fungus. Side stones were cracked, eroded, mossed and with missing parts.

### Facades and drum of the dome

The stones of the facades and drum were crumbled, cracked and with growing plants. Cement pointing from previous restoration had eroded the original stones and the sandstone additions were bound with cement mortar, consequently damaging original stones behind them.

**Korniza e derës së minares** - Guri përmbi derë të minares ishte i çarë në pjesët anësore. Guri ishte i gërryer dhe i mbuluar me kërpudha. Gurët anësorë kanë pasur çarje, abrazion, mungesë të pjesëve dhe myshqe.


### Fasadat dhe tamburi i kupolës

Gurët e fasadave dhe tamburit ishin të shkapërderdhura, të çara, dhe me rritje biologjike. Mbushjet me llaç të çimentos të punuara gjatë restaurimit të mëparshëm kishin gërryer gurët origjinalë, kurse shtimet me gurë zallorë ishin të lidhura me llaç çimentoje, e që si pasojë ka dëmtuar gurët origjinalë prapa tyre.



*Cracks on minaret door*  
*Të çarat në derë e minares*





- |                 |              |                 |
|-----------------|--------------|-----------------|
| Crack           | Algae        | Loss of plaster |
| Decomposed      | Sharp lines  | Qualifier       |
| Frosting        | Only surface | Mural           |
| Surface erosion | Sock         |                 |


documentation project  
damage analysis  
ENTRANCE FACADE

Location: Municipality of Gjakova  
Architect: Mustafa Perihomajli

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE








- |                 |              |                  |
|-----------------|--------------|------------------|
| Crack           | Algae        | Crack in plaster |
| Decomposed      | Damp issue   | Oxidation        |
| Frosting        | Only surface | Steel            |
| Surface erosion | Soil         |                  |

documentation project  
damage analysis  
**BACK FACADE**  
Location: Municipality of Gjakova  
Architect: Mustafa Pelikromçiu

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE






- |                  |               |                 |
|------------------|---------------|-----------------|
| Crack            | Algae         | Loss of plaster |
| Decomposed       | Mold issues   | Oxidation       |
| Fracture         | Dirty surface | Water           |
| Surface abrasion | Soot          |                 |

documentation project  
damage analysis  
LEFT FACADE

location: Municipality of Gjakova  
architect: Muarrete Pehivramogji

CONSERVATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE





- |                  |               |                 |
|------------------|---------------|-----------------|
| Crack            | Algae         | Loss of plaster |
| Decomposed       | Damp issue    | Oxidation       |
| Fracture         | Dirty surface | Mold            |
| Surface abrasion | Soot          |                 |

documentation project  
 damage analysis  
 RIGHT FACADE

Location: Municipality of Gjakova  
 architect: Martin Polivkavogji

RESTORATION OF  
 "HADUM SULEIMAN EFENDI"  
 MOSQUE



*On-ground construction of wooden cornice for “qylah”*

*Ndërtimi i konstruksionit të drurit të qylahut*



## IMPLEMENTATION PHASE

### The Minaret

The main problem during restoration and reconstruction of the minaret was identification of stones for reconstruction of the upper part of the minaret shaft ("petek"). After months of investigation, good and appropriate stone was found in a quarry in Samadrexhe close to Vushtrri/Vucitrn. These stones, as well as the ones from the existing minaret shaft, were sent for mineralogy and petrography analyses to the Institute for Materials Research in Skopje. The analyses have shown that stones from the Samadrexhe quarry met the criteria in the aspect of resistance to pressure. The stones were first processed in the quarry, then further by workshop craftsmen, who made holes for metal clamps to bind the stones together. These clamps were made of iron resistant to corrosion, while stones were joined using lime mortar. Finally, the ring-cornice and its engraved details around the top end of the stone minaret were completed.



*Minaret shaft stones bound with iron clamps*

*Lidhja e gurëve të trupit të minares me kllanfa metalike*

*Ring-cornice of minaret*

*Kurora rrethore e minares*

## FAZA E IMPLEMENTIMIT

### Minarja

Gjatë restaurimit dhe rekonstruimit të minares, problemi kryesor ka qenë identifikimi i gurëve për rekonstruimin e petekut. Pas disa muaj kërkimesh, gurët i kemi gjetur në gurëthyesin në Samadrexhë afër Vushtrrisë. Këto gurë, si dhe gurët nga trupi ekzistues i minares janë dërguar për analiza mineralogjike dhe petrografike në Institutin për Hulumtimin e Materialeve në Shkup. Analizat kanë treguar se gurët nga gurëthyesi i Samadrexhes i plotësojnë kriteret e kërkuara në aspekt të rezistencës ndaj shtypjes. Gurët së pari janë përpunuar në gurëthyes, e më pas nga mjeshtrit e gurit në punishte, të cilët hapur vrimat për lidhjen me kllanfa metalike. Këto kllanfa janë punuar nga hekuri i qëndrueshëm ndaj ndryshkut, kurse gurët më pas janë murosur në vend me llaç gëlqeror. Në fund është punuar unaza-kurora me detale specifike në lartësinë e përfundimit të pjesës së minares me gurë.

Mbi këtë kurorë është formuar remenata prej druri, si bazë për formimin e konstruksionit konik të qylahut. Në mes të këtij konstruksioni është vendosur shtylla kryesore nga druri e gjatë 11 metra, e mbështetur në sherefe dhe në majën e kulmit, duke shërbyer si mbështetje për trarët e konstruksionit të





On top of this cornice, a wooden roof construction was built to be used as a base for the conical roof of the minaret ("qylah"). In the centre of the minaret, an eleven-meter tall wooden pillar was erected from the balcony up to the top of the roof, serving as a support for the timber. The construction was covered with wooden boards, 1 cm thick cloth insulation and covered with lead sheet. On top of the minaret, 32 m above the ground, a brass ornament ("alem") was placed.

On the lower part of the minaret shaft under the sherefe, the many damaged stones were replaced with great care. Since the minaret was constructed of three different types of stones, it suffered different damages and they had to be treated accordingly. The lower

qylahut. Qylahu është i dërrasuar, është vendosur izolimi prej 1cm trashësi, dhe më pastaj është mbuluar me llamarinë plumbi. Në fund, është vendosur alemi prej mesingu, i cila kurorëzon minaren në lartësinë 32,25 m nga toka.

Në pjesën e poshtme të trupi i minares ndër sherefe, gurët e shumtë të dëmtuar janë zëvendësuar me kujdes të madh.

Meqenëse minarja është prej tri llojeve të gurëve, ajo ka pësuar dëmtime të ndryshme, të cilat janë dashur të trajtohen në mënyrë specifike. Pjesës së poshtme të trupit të minares, e cila është e punuar prej gurit gëlqeror më të butë dhe ishte më e dëmtuar, iu është kushtuar kujdes i veçantë.



*The eleven-meter-tall wooden pillar supporting "qylah" construction*

*Trau njëmbëdhjetë metra i gjatë ku mbështetet konstrukcioni i qylahut*

part of the minaret shaft, constructed of softer limestone, was damaged to greater extent and, thus, was treated in particular.

Initially, the whole minaret shaft was cleaned from cement mortar, moss and algae, in a way so the stones would not be damaged. The cement mortar was removed with small chisels and hammers. Moss and algae were removed with water and scrubbing with soft brushes, while in places where they could not be removed with water, biocide was used.

Then, consolidation of stones started. The lower part of the minaret shaft was consolidated with "ethyl silicate", which was applied on stones with brushes, until the stones were saturated. This material needs 14 days to react, and during this period, the treated stones have to be protected from direct sunlight and rain. The minaret was covered with thick net around the scaffolding and thick plastic over the scaffolding.


Së pari e tërë minarja është pastruar prej llaçit të çimentos dhe nga myshqet e algat, por me kujdes që të mos dëmtohen gurët. Llaçi i çimentos është hequr me dalta të vogla dhe çekan. Myshqet dhe algat janë larguar me ujë duke u fërkuar brusha të buta, ndërsa në pjesët ku heqja e tyre nuk ka qenë e mundur me ujë, është përdorur biocidi.

Pastaj është filluar me konsolidimin e gurëve. Pjesa e poshtme e trupit të minares është konsoliduar me etil silikat (ethyl silicate), i cili është aplikuar me brushë derisa gurët nuk janë ngopur. Këtij materiali i duhen 14 ditë për të reaguar, dhe brenda kësaj kohe gurët e trajtuar duhet të jenë të mbrojtur nga drita e drejtpërdrejtë dhe lagështia. Minarja është mbështjellur me rrjetë të dendur përreth skelave dhe me najlon të trashë përsipër skelave.

Në ndërkohë, kemi vazhduar me punën në pjesën e sipërme të minares. Gurët në këtë pjesë të minares janë më të fortë dhe nuk ka pasur nevojë për ndonjë intervenim të posaçëm, përveç ndonjë çarje e cila është mbushur me epoksi rezinë (epoxy resin) apo



*"Alem" - minaret  
brass ornament*  
Alemi i minares



*Cleaning of  
minaret shaft*  
Pastrimi i trupit të  
minares



*Workers removing the protective cover of minaret shaft*

*Punëtorët duke e hequr mbulesën mbrojtëse të trupit të minaret*

Meanwhile, the work on the upper part of the minaret continued. The stones on this part of the minaret are stronger and there was no need for any particular intervention, except when some cracks were filled with epoxy resin, or when missing parts of stones were filled with mortar. Mortar made of hydraulic lime, sand and stone dust was used to fill in the joints.

After two weeks, stones in the lower part of the shaft were evidently consolidated. Then the cracks were filled with epoxy resin, the missing parts of the stones were added and the pointing with the lime mortar was done.

The lower part of the sherefe, besides being eroded, also had black crust on the surface of stones, which was removed with the help of consolidating materials: 'edta', ammonium bicarbonate and grinded paper. This mixture was put on parts with black crust, left to act from 30 minutes to one and a half hour, and then it was removed with brush and water. The crust was removed with great care, because the stones had pigments.

The damaged sherefe ornaments were covered with ethyl silicate, and after two weeks, joints were filled in, while the ornaments were reshaped with lime mortar.

mungesë të ndonjë pjese të gurit e cila është mbushur me llaç. Për llaçin e fugave është përdorur gëlqere hidraulike, rërë dhe pluhur i gurëve të llojit të njëjtë.

Pas dy javësh është vërejtur konsolidim i dukshëm i gurëve në pjesën e poshtme. Çarjet janë mbushur me epoksi rezinë (epoxy resin), janë shtuar pjesët që kanë munguar dhe janë bërë mbushjet me llaç gëlqeror.

Pjesa e poshtme e sherefesë, pos abrazionit, ka pasur edhe një shtresë të zezë në sipërfaqe të gurëve e cili është larguar me anë të materialeve konsoliduese: `edta`, bikarbonatit të amoniumit (amonium bicarbonate) dhe letrës së bluar. Kjo përzierje është vendosur në pjesët me shtresë të zezë, është lënë të veprojë prej 30 minutave deri në një orë e gjysmë, dhe pastaj është larë me brushë dhe ujë. Është fërkuar me shumë kujdes sepse në gurë ka pasur pigmente.

Ornamentet në sherefe të cilat kanë qenë të dëmtuara janë lyer me etil silikat (ethyl silicate), dhe, pas dy javësh, janë rimbushur fugat dhe janë riformuar ornamentet me llaç gëlqeror.

*Reconstruction of "petek", using hydraulic lime to connect the joints*

*Rikonstruimi i petekut, duke përdorur llaç hidraulik për lidhjen e gurëve*



*Chiseling of new stone slabs for "sherefe" - balcony parapet*

*Gdhendja e pllakave të reja të gurit për parapetin e sherefesë*





### The dome

Due to the quality and damages of the aged lead covering, it was decided to replace the lead on the dome with new, 2 mm thick lead. Finding proper lead in a post-war situation was a complicated task. After a number of trials, we ended up with lead from Turkey.

Works on the dome were divided in two phases. The first phase started at the end of October 2004 and, during this phase, only six segments were changed

On recommendation of Professor Ahunbay, a Turkish Master craftsman working on Haghia Sofia, Ahmet Semih Ucar, was engaged to train the local craftsmen on how to cover the dome.

### Kupola

Për shkak të kualitetit dhe dëmeve në mbulesën prej plumbit, është vendosur që mbulesa të zëvendësohet me plumb të ri me trashësi prej 2 mm. Gjetja e plumbit në periudhën e pasluftës ishte shume e vështirë, kështu që përfundimisht plumbi për mbulesë u soll nga Turqia.

Punimet në kupolë kanë qenë të ndara në dy faza. Faza e parë ka filluar në fundin e muajit tetor 2004 dhe janë ndërruar vetëm gjashtë segmente.

Me rekomandimin e prof. Ahunbay, kemi angazhuar ekspertin turk Ahmet Semih Ucar i cili ka punuar edhe në Haghia Sofia, i cili ka trajnuar mjeshtrit lokalë rreth mbulimit të kupolës. Punët në kupolë kanë filluar me zhveshjen e dy seg-



*Craftsmen removing the lead sheets from the dome*

*Mjeshtrit duke e hequr mbulesën e plumbit nga kupolla*



Works on the dome started with the removal of the first two segments. After this, a 10 cm thick soil and straw insulation layer on top of the dome bricks, serving as an insulator and buffer, was replaced. The new segments were cut and prepared from rolls of lead, using the same dimensions as the old ones. They were mounted after the insulation and buffer layer had dried. This work is carried out from the lower part and it continues upwards in order to create vertical and horizontal connections between these segments.

The remaining work on the dome started in May 2005 and was completed in August. It is worth mentioning that local craftsmen, with good result, did this work.

menteve të para. Pas heqjes së këtyre dy segmenteve, shtresa izoluese nga dheu dhe kashta me trashësi prej 10 cm, është zëvendësuar. Segmentet e reja janë prerë dhe përgatitur nga llamarinina e plumbit me dimensione të njëjta, të cilat u vendosën në kupolë pas tharjes së shtresës izoluese dhe amortizuese të dheut. Teknika e vendosjes është nga poshtë- lartë, në mënyrë që të krijohen lidhjet vertikale dhe

Pjesa tjetër punëve në kupolë ka filluar në maj të vitit 2005 dhe është përfunduar në gusht. Vlen të përmendet se mjeshtrit vendorë e kanë kryer këtë punë me rezultate të kënaqshme.



*Craftsmen replacing the lead sheet on top of soil and straw insulation layer*

*Mjeshtrit duke zëvendësuar mbulesën e plumbit mbi shtresën izoluese të punuar nga dheu dhe kashta*

### The portico

After analysis of damages, we started with consolidation of the portico columns using syringe injections. Initially alcohol was injected, since it penetrates very fast, cleaning the channels and, at the same time, showing the direction of cracks. Once every crack was identified, they were isolated with latex and plasticine, leaving one hole for injection on the highest point of the crack. Then the consolidating-gluing material, epoxy resin was injected. This material penetrates rather fast too, but it has to be injected slowly, in order to prevent formation of any air bubbles or staining the surface of the stone with yellow stains.

Fiberglass rods of different diameters and lengths were used to put cracks together, depending on the damage and needs. First, the stone was drilled at required diameter, the dust was removed, and then epoxy resin was injected, followed by placement of fiberglass rods, and a final injection of epoxy resin, until the hole was completely filled. In places where stones were missing, lime-based mortar and stone



### Portiku

Pas analizave të dëmtimeve, është filluar me konsolidimin e shtyllave të portikut me anë të injektimit me shiringa. Fillimisht është injektuar alkooli, për shkak se depërton shumë shpejtë, i pastron kanalet dhe tregon shumë qartë drejtimin e çarjeve.

Pasi që është gjetur drejtimi i çarjeve, secila çarje është izoluar me lateks dhe plastelinë, duke e lënë nga një vrimë për injektim në pikën më të lartë të çarjes. Pas kësaj është injektuar materiali ngjitës-konsolidues, epoksi rezina (epoxy resin). Edhe ky material depërton mjaft shpejt, por duhet injektuar ngadalë në mënyrë që të mos mbetet ndonjë fluskë e ajrit, dhe të parandalohet dalja në sipërfaqe të gurit, me ç'rast mbesin njolla të verdha.

Shufra prej fijeve të xhamit me diametër dhe gjatësi të ndryshme janë përdorur për t'i ngjitur çarjet, varësisht prej dëmtimit dhe nevojave. Së pari është shpuar guri në diametrin e duhur, është hequr pluhuri dhe më pas është injektuar epoksi rezina (epoxy resin) dhe është vendosur shufra, dhe në fund është injektuar prapë epoksi rezina (epoxy resin) derisa vrima është ngopur.

Vendet ku kanë munguar pjesë të gurit janë mbushur me llaç në bazë të gëlqeres dhe copa të

*Injection of epoxy resin and insertion of fiberglass rods to fill in the cracks and bind the stones*

*Injektimi i epoksi rezinës dhe vendosja e shufrave me fije qelqi për t'i mbushur të çarat dhe lidhur gurin*



pieces were filled in. The column, which suffered a direct hit and which was missing a part, was reinforced with fibreglass of 6 mm diameter in several places. A non-corrosive wire net was added and filled with horasan mortar (mortar made of brick, sand and hydraulic lime) and stone pieces. The surface was covered with plaster made of marble dust, sand and hydraulic lime. The same plaster was used for filling in the larger pores of the column.

The existing thin plaster was damaged and even missing in large parts of the columns. Its remaining parts were conserved, while the other parts were filled in with new plaster.

Column capitols and bases were injected with epoxy resin and their hollow parts were filled in with lime mortar (they were not plastered). Capitols had pigments, so they were treated with special care.

The damaged stones on the edges of the portico floor, were taken out, rotated and put back in place, showing its preserved sides.

gurëve. Shtylla e cila ka pësuar goditje direkte dhe së cilës i ka munguar një pjesë, është përforuar me shufra xhami me diametër prej 6mm. Më pas është shtuar rrjeta me tel i cili nuk ndryshket, pastaj kjo brendi është mbushur me llaç `horasan` (llaç me përbërje të tullës, rërës dhe gëlqeres hidraulike) dhe copa të gurëve. Ndërsa sipërfaqja është mbuluar me llaç i cili përmban pluhur të mermerit, rërë dhe gëlqere hidraulike. Po ashtu edhe poret e mëdha të shtyllës janë mbushur me po të njëjtin llaç.

Llaçi mbështjellës ekzistues i shtyllës ka qenë i dëmtuar dhe ka munguar në shumë pjesë të shtyllave. Llaçi ekzistues është ruajtur, ndërsa në pjesët tjera është mbushur me llaç të ri gëlqeror.

Kapitelet dhe bazat e shtyllave janë injektuar me epoksi rezinë (epoxy resin), kurse pjesët e zbrazëta janë mbushur me llaç gëlqeror (nuk iu është vënë llaç mbështjellës). Në kapitole ka pasur pigmente ndaj të cilave është kushtuar kujdes që të mos dëmtohen më tepër.

Gurët e dëmtuar në skajet e parapetit të dyshemesë së portikut, janë nxjerr prej vendit dhe janë rrotulluar kah ana e shëndoshë e tyre.

*Filling in of cracks*

*Mbushja e të çarave*




*The damaged pillar filled in with horasan*

*Mbushja e shtyllës së dëmtuar me horasan*







Coating of window stones with ethyl silicate  
*Lyerja e gurëve të dritareve me etil silikat*



Lower window with replaced frame stones  
*Dritarja e poshtme me gurë të zëvendësuar*



Cleaning of moss from window frames  
*Pastrimi myshqeve nga kornizat e dritareve*

### **Window and Door Frames**

The cement mortar on all window frames was removed and they were carefully cleaned from moss. In some places, stones were damaged and parts of them could easily fall off. In places where we could not remove moss and algae by using only water, we also used biocide.

#### **Right and left windows on the western façade:**

The stones were coated with ethyl silicate. After two weeks, bandages were put on damaged parts of the stones, which were in risk of falling off, in order to keep them together. After reinforcing the stone structure, hollow parts in stones were filled in with a special ready-to-use mortar that is used for these cases.

Vertical stones have been injected with epoxy resin. After removing cement mortar from the lower horizontal stone of the right window on the western façade, we replaced it with lime mortar.

#### **Right window on the southern façade:**

The heavy sand stones on the upper part of the window, which were added during previous intervention, were removed. In their place, we put limestone with lighter weight. In order to prevent further burdening of the upper horizontal stone of the windows, before placing the stones, we inserted a fiberglass rod with 2 cm diameter, supported on both sides on the walls, in order to distribute the weight of the upper stones. The new stones were connected with each other using U profiles and melted lead, while fiberglass rods were used to bind them with the walls.

Horizontal and vertical stones were cleaned from moss, coated with ethyl silicate and epoxy resin was injected in cracks, while hollow parts were filled in with lime mortar. Larger cracks and displaced stones were connected with fiberglass.

#### **Left window on the southern façade:**

was cleaned from moss and was coated with ethyl silicate. After two weeks, we connected displaced stones using fiberglass rods; the cracks were filled in with epoxy resin and hollow parts were filled in with lime mortar.

### **Kornizat e dritareve dhe dyerve**

Në të gjitha dritaret është hequr llaçi i çimentos dhe janë pastruar myshqet me shumë kujdes. Në disa vende gurët kanë qenë shumë të lëvorosur dhe kishte rrezik që pjesët t[u] bien. Në vendet ku myshqet dhe algat nuk ka qenë e mundur të largohen vetëm me ujë aplikuar biocidi.

#### **Dritarja e majtë dhe e djathtë në fasadën perëndimore:**

Gurët janë lyer me etil silikat (ethyl silicate). Pas dy javësh, në pjesët e dëmtuara të gurëve, që ishin në rrezik të bien, iu janë vënë fashat për t'i mbajtur të bashkuara. Pas forcimit të strukturës së gurit, zbrazëtitat në gurë janë mbushur me një llaç të gatshëm special për këto raste.

Gurët vertikale janë injektuar me epoksi rezinë (epoxy resin). Pas heqjes së llaçit të çimentos nga guri horizontal i dritares së djathtë në fasadën perëndimore, e kemi zëvendësuar me llaç gëlqeror.

#### **Dritarja e djathtë në fasadën jugore:**

Janë hequr gurët zallorë me peshë të rëndë që ishin vendosur në pjesën e sipërme të dritares gjatë intervenimeve të mëparshme. Në vend të tyre janë vendosur gurë gëlqerorë me peshë më të vogël. Për t'iu shmangur ngarkimit të mëtejshëm të gurit të sipërm horizontal të dritares, para vendosjes së gurëve është vendosur një shufër qelqi me diametër prej 2cm e cila është mbështetur në të dy anët në mure në mënyrë që të shpërndajë peshën e gurëve përsipër. Gurët e ri janë lidhur në mes veti me anë të U profileve dhe me plumb të shkrirë, ndërsa me murin janë ngjitur me shufra të qelqit.

Gurët horizontale dhe vertikale janë pastruar prej myshqeve, janë lyer me etil silikat (ethyl silicate), ndërsa në çarje është injektuar epoksi rezina (epoxy resin) e zbrazëtitat janë mbushur me llaç gëlqeror. Çarjet e mëdha dhe gurët që kanë lëvizur janë lidhur edhe me shufra të qelqit.

#### **Dritarja e majtë në fasadën jugore:**

Është pastruar prej myshqeve dhe është lyer me etil silikat (ethyl silicate). Pas dy javësh, gurët që kanë lëvizur janë lidhur në mes veti me shufra të qelqit, çarjeve u është injektuar epoksi rezina dhe është bërë mbushja e zbrazëtitave me llaç gëlqeror.





*Filling in of space between minaret stones and door*  
*Mbyshja e zbrazëtirës mes derës dhe gurëve të minares*



*Coating with ethyl silicate*  
*Lyerja me etil silikat*

**Right and left windows on the Eastern facade:**

They were cleaned from moss and were coated with ethyl silicate. After two weeks, inadequate sandstones from previous interventions were removed. Displaced stones and cracks were bound together with fibreglass rods and injected with epoxy resin. In the end, the hollow parts were filled in with lime mortar.

**Minaret doorframe:**

the frontal part of the mosque burned down, melted lead dripped on the surface of the walls and stuck on them. This layer was removed using scalpels. The minaret doorframe was treated in a similar way as we treated the minaret and windows, since they are constructed with the same type of stones. After removing the lead, the stones were cleaned from moss and coated with ethyl silicate.

After two weeks, the crack on the upper stone was connected with fibreglass rod and injected with epoxy resin. The 5-6 cm space between this stone and the minaret stones was filled in with pieces of stone and mortar. This upper stone was connected with stones behind it, using fibreglass rods, in order to reinforce it properly. Finally the hollow parts were filled with lime mortar.

The vertical stone on the right side of minaret doorframe was missing one part. A new limestone was chiselled, identical to the original one, and glued using epoxy resin and fibreglass rods. The vertical stone on the left side of the door as well as the doorstep were cleaned from melted lead and

**Dritarja e djathtë dhe e majtë në fasadën lindore:**

Janë pastruar prej myshqeve dhe janë lyer me etil silikat. Pas dy javësh, janë hequr gurët zalorë joad-ekuat, nga intervenimet e mëparshme, dhe janë vendosur gurë gëlqeror. Gurët që kanë lëvizur dhe çarjet janë lidhur në mes veti me shufra të qelqit dhe është injektuar epoksi rezina. Në fund është bërë mbushja e zbrazëtirave me llaç gëlqeror.

**Korniza e derës së minares:**

Kur është djegur pjesa e përparme e xhamisë, plumbi i shkrirë ka rrjedhur nëpër mure dhe është ngjitur. Kjo shtresë është larguar me anë të skalperëve. Korniza e derës së minares është trajtuar në mënyrë të ngjashme sikurse minarja dhe dritaret sepse guri është i njëjtë. Pas heqjes së plumbit është bërë pastrimi nga myshqet dhe gurët janë lyer me etil silikat.

Pas dy javësh, çarja në gurin e epërm është lidhur me shufra të qelqit dhe është injektuar epoksi rezina. Hapësira 5-6 cm, që ishte krijuar në mes të këtij guri dhe gurëve të minares është mbushur me copa të gurëve dhe me llaç. Edhe tërthorazi ky gur është lidhur me gurët në pjesën e pasme të tij me shufra qelqi në mënyrë që të shtangohet më mirë. Pastaj zbrazëtirat janë mbushur me llaç gëlqeror.

Gurit vertikal në anën e djathtë të kornizës së derës i ka munguar një pjesë. Është gdhendur guri i ri gëlqeror i njëjtë me atë burimor dhe është ngjitur me epoksi rezinë dhe me shufër qelqi. Guri vertikal në anën e majtë të derës dhe pragu janë pastruar



*Replacement of the missing part*

*Zëvendësimi i pjesës që mungon*





*Back façade before restoration*

*Fasada e pjesme para restaurimit*



moss, coated with ethyl silicate, and injected with epoxy resin. Their hollow parts were filled in with lime mortar.

### The Façades

The façades had cement pointing from previous restorations, when also many dark grey pieces of sandstone, bound with cement mortar, were added. All cement pointing and mortar, and later sandstones were removed; they were replaced with adequate stones taken from the remains of a building near the mosque. The new stones were joined with lime mortar.

The mortar that would be used for infill was tested in order to be compatible with the façade stones. The infills were tightly pressed with sponge in order to remove as much air as possible from them, and then they were washed with water in order to remove the white colour of lime.

prej plumbit të shkrirë dhe myshqeve, janë lyer me etil silikat, është injektuar epoksi rezina dhe zbrazëtitrat janë mbushur me llaç gëlqeror.

### Fasadat

Në fasada ka pasur intervenime me llaç të çimentos nëpër fuga, dhe me gurë zallorë me ngjyrë të hirtë të mbylltë që kanë qenë të murosur me llaç të çimentos. Të gjitha fugat me llaç të çimentos dhe gurët zallorë janë hequr dhe janë zëvendësuar me gurë adekuat të marrë nga rrënoja e një objekti në afërsi të xhamisë. Gurët e ri janë murosur me llaç gëlqeror.

Llaçi i përdorur për fuga është testuar paraprakisht për ta përcaktuar kompatibilitetin me gurët e fasadës. Fugat e vendosura janë shtypur fort me shpuzë në mënyrë që të largohet ajri dhe pastaj secila fugë është larë me ujë në mënyrë që të humbet ngjyra e bardhë e gëlqeres dhe që llaçi të përshatet me gurët e fasadave.



*Replacement of façade stones*

*Zëvendësimi i gurëve të fasadës*

*Back and side façades after restoration*

*Fasada e pasme dhe anësore oas restaurimit*





In some places, traces of lime from the porch, which was connected to the wall of the minaret before it was burnt, were blasted with aluminium oxide.

On the cornice, the cement mortar was removed and the stones were consolidated with epoxy resin and reshaped with lime mortar.

Iron shutters from the upper windows were removed and replaced with grids made of white cement (originally gypsum is too vulnerable today, due to the polluted air). The grids were made in the mosque yard by the conservators from the Kosovo Institutes for Protection of Monuments.

Badly damaged stones from the wider façade base around the mosque were extracted, rotated to their preserved side and put back in place, as in the portico floor.

Në disa vende ku ka pasur gjurmë të gëlqeres prej murit të hajatit që ka qenë i ngjitur për murin e minares para djegies, janë pastruar me oksid të aluminut.

Prej skajeve të epërme të xhamisë është larguar llaçi i çimentos, gurët janë konsoliduar me epoksi rezinë dhe përsëri janë riformuar me llaç gëlqeror.

Dritareve të epërme u janë hequr grilat e hekurta dhe janë vendosur ato të reja të punuara nga çimentoja e bardhë (grilat origjinale janë të punuara nga gipsi, i cili është tepër i ndjeshëm ndaj ndotjes në ditët e sotme). Grilat janë punuar në oborrin e xhamisë nga konservatorët e instituteve kosovare për mbrojtjen e monumenteve.

Gurët e skajeve-parapetit të poshtëm të përreth xhamisë janë nxjerr dhe janë rrotulluar kah ana e shëndoshë e tyre, sikurse në parapetin e portikut.



*Replacement of iron shutters with white cement grid*

*Zëvendësimi i grilave të hekurit me rrjetën nga çimentoja e bardhë*



## Protection against humidity

In 2003 Professor dr. Salei Lamei measured high percentage of humidity of the mosque floors and walls. Professor Zeynep Ahunbay concluded that the humidity was primarily caused by 40-50 cm additional soil infill around the mosque done 20-30 years ago. Also, there was no adequate drainage around the building. Consequently, the soil level around the building was lowered to its original level (25-30 cm under the level of the floor inside the mosque) and drainage was made using PVC tubes placed 120 cm under the level of floor. The drainage around the building was connected to the town's precipitation drainage system.

The foundation was isolated with horasan plaster, which was prepared according to Professor Ahunbay's instructions and a vertical layer of thirty-centimetre clay was placed outside the plaster (Note: Horasan plaster was previously used as an insulator, especially in communal baths - hamams). Finally a pavement with stone slabs of 1,5 meter width, sloping out from the building, ended with 30-cm drains openings with metal rails in the drainage system.

## Mbrojtja nga lagështia

Në vitin 2003, prof. Dr S. Lamei mati nivel të lartë të lagështisë në muret dhe dyshemenë e xhamisë. Profesor Zeynep Ahunbay konstatoi se kjo lagështi është shkaktuar nga mbushja e dheut përreth xhamisë që ishte rreth 40-50 cm mbi nivelin e dyshemesë, që ishte bërë para 20-30 viteve. Krahas kësaj, objekti nuk kishte sistem adekuat të drenazhimit. Rrjedhimisht, kemi ulur nivelin e dheut përreth objektit në nivelin origjinal (25-30cm nën nivelin e dyshemesë brenda xhamisë) dhe në nivel prej 120 cm nën dysheme vendosëm tuba nga PVC-ja për drenazhim. Drenazhimi i punuar përreth objektit është lidhur me rrjetin e kanalizimit atmosferik të qytetit.

Themelet janë izoluar me llaç horasan, i cili është përgatitur me udhëzimet e Profesor Ahunbay-it, dhe mbi këtë shtresë është vendosur një shtresë vertikale prej argjilës me trashësi prej 30 cm. (Shënim: Llaçi horasan është përdorur më herët si izolator, posaçërisht në banjat publike - hamamet). Përfundimisht, janë punuar trotuaret prej pllakave të rrafshëta të gurit me gjerësi prej 1,5 m, në fund të të cilave janë vendosur rigolat e hapura prej 30cm me ujëmbledhëset prej grilave metalik.

*Insulation of foundation with horasan plaster*

*Izolimi i themeleve me llaç horasan*



*Pavement and drain-openings surrounding the building*

*Shtigjet me hapje për drenazhim të vendosura përreth objektit*



## The yard

As a part of yard arrangement, paths with stone slabs on both sides of the mosque entrance were made. The remaining part of the yard was cleaned, filled in with humus and landscaped.

## Oborri

Në kuadër të rregullimit të oborrit është bërë edhe rregullimi me gurë i qasjeve në të dy anët e hyrjes në xhami. Pjesa tjetër e oborrit është pastruar, mbushur me humus dhe është gjelbëruar, kurse shtigjet janë shtruar me pllaka.

*The backyard*

*Oborri i pasëm*




*Construction of paths with stone slabs in mosque's yard*

*Punimi i shtigjeve me pllaka guri në oborrin e xhamisë*



**CH  
WB**

CHWB  
Cultural Heritage Workshop  
10000000000000000000




**exécutive project  
FLOOR PLAN**

Location: Municipality of Tepic  
Colonia: 3. Municipal Petrolero

**RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE**





executive project  
**GALLERY PLAN**  
Division: Municipality of Ghetto  
District: Muamala Park/Boyleston

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE








**executive project**  
**ROOF PLAN**  
Beylikbey, Municipality of Gataoğlu  
04/2011, Mustafa Fehim Beylikbeyli

**RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE**






executive project  
**ENTRANCE FACADE**  
for the Municipality of Kollata  
District, Mumbai Metropolitan

**RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE**



CH  
WB

Cutout  
Through vertical planes  
© 2010 CHWB




executive project  
BACK FACADE

location: Municipality of Gjirokastra  
country: Albania

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE






executive project  
LEFT FACADE  
Beşiktaş, Municipality of Şişli  
Istanbul's Mosaic Patrimonia

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE








executive project  
**RIGHT FACADE**  
2011-2012, Muhiiddin Aliyev  
2012-2013, Muzikhanliyev

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE






executive project  
SECTION A-A  
İstanbul, Municipality of Şişli  
Mimarlar Odası İstanbul Şubesi

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE



CH  
WB

CHW B  
1992-2000



executive project

SECTION A'-A'


Hadum Suleiman Efendi Mosque  
1992-2000, Mustafa Fehimoglu

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE



CH  
WB

CH  
WB  
CONSULTANTS



executive project


SECTION B-B

Hadum Suleiman Efendi Mosque  
Hadum Suleiman Efendi Mosque

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE







exécution project  
SECTION C-C  
Municipality of Gatineau  
Municipalité de Gatineau

RESTORATION OF  
"HADUM SULEIMAN EFENDI"  
MOSQUE



## CONSERVATION MATERIALS USED

**Hydraulic lime** - was used for preparing (making) mortar and plaster;

**Fibreglass rods** - with diameter 2, 4, 6, 8mm and 2cm - were used for joining the stone cracks and consolidation of stone structure;

**Epoxy resin** - consolidator, a mixture of two components: EPO150 - a product based on epoxyde fluid glue, moderately cold, and K151 - fortifier based on cycloalfatic amine. This mixture provides highly resistant binding material;

**Ethyl silicate** - consolidating product for natural stone composed of ethylic ester of silicate acid which penetrates all the way to the healthy parts of the stone. Ethylic ester of silicate acid reacts with atmospheric humidity and it transforms into a silica gel and ethylic alcohol. The silica gel, thanks to its strong chemical bonds, creates new mechanical properties for the treated surfaces;

**EDTA** - bisodic salt;

**Ammonium bicarbonate** ( $\text{NH}_4\text{HCO}_3$ );

**Grinded paper** - The mixture of EDTA, ammonium bicarbonate and grinded paper was used for removal of black crust from the stone surface;

**Ledan** - ready-to-use mortar, soluble in water. Used for filling in damaged stones;

**Plasticine** - was used for closing the cracks during injection of epoxy resin;

**Latex** - was used for closing the cracks during injection of me epoxy resin;

**Aluminium oxide** - was used for cleaning of stones with compressor;

**Biocide** - was used for removal of moss and algae;

**Stone pieces**, sized 2mm of different colours - were used for infill mortar;

**Black marble dust** - was used for wall infill mortar;

**White marble dust** - was used for column surface plaster;

**Grinded brick** - was used for preparing horasan mortar and giving the right colour to it.

## MATERIALET KONSERVUESE TË PËRDORURA

**Gëlqere hidraulike** - është shfrytëzuar për përgatitjen e tërë llaçit të nevojshëm;

**Shufra me fije të qelqi** - me diametër 2, 4, 6, 8mm e 2cm - janë shfrytëzuar për bashkimin e çarjeve të gurëve e konsolidimin e strukturës së gurëve;

**Epoksi rezina** - konsolidues, përzierje e dy komponentëve: EPO150 - është një produkt në bazë të ngjitësit epoksid fluid, mesatarisht i ftohtë dhe K151 - forcues në bazë të aminës cikloalfatike. Kjo përzierje e këtyre dy komponentëve prodhon një sistem të lartë rezistues;

**Etil silikati** - prodhim konsolidues për gurë natyralë, kompozuar prej esterit etilik të acidit silikat që depërton deri në pjesët e shëndosha të gurit. Esteri etilik i acidit silikat reagon në lagështinë atmosferike dhe transformohet në xhel të silicit dhe alkool etilik. Xheli i silicit falë lidhjes së fortë kimike, krijon veti të reja mekanike në sipërfaqet e trajtuara;

**EDTA** - kripë bisodike;

**Bikarbonati i amoniumit** ( $\text{NH}_4\text{HCO}_3$ );

**Letër e bluar** - Përzierja e EDTA-së, e bikarbonatit të amoniumit dhe letërës së bluar, është shfrytëzuar për largimin e shtresës së zezë në sipërfaqe të gurëve;

**Ledan** - llaç i gatshëm gëlqeror i cili tretet me ujë. Është shfrytëzuar për t'i mbushur gurët e lëvorosur;

**Plastelinë** - është shfrytëzuar për mbylljen e çarjeve gjatë injektimit me epoxy resin,

**Latex** - është shfrytëzuar për mbylljen e çarjeve gjatë injektimit me epoxy resin,

**Oksid i aluminit** - është shfrytëzuar për pastrim të gurëve nëpërmes të kompresorit;

**Biocid** - është shfrytëzuar për largimin e myshqeve dhe algave;

**Copëza të gurëve**, me madhësi 2mm të ngjyrave të ndryshme - janë shfrytëzuar për llaçin e fugave të mureve;

**Pluhur i mermerit të zi** - është shfrytëzuar për llaçin për fuga të mureve;

**Pluhur i mermerit të bardhë** - është shfrytëzuar për llaçin në sipërfaqe të shtyllave;

**Tullë e bluar** - është shfrytëzuar për llaçin horasan dhe për përfitimën e ngjyrës së kërkuar të llaçit.

## OTHERS VOICES ABOUT HADUM MOSQUE RESTORATION

**OSMAN GOJANI**, *Architect,  
Director of IPMK in Gjakova*



Hadum Mosque is of a religious importance not only for the craftsmen of Carshia e Madhe (Great Market Street) but also for the whole town of Gjakova. Its closeness with xhemat (worshippers) is particularly positive and functional. As a monument of culture, this mosque had great architectural and artistic values, including mural paintings. Having this in mind, this monument could contribute to development in different fields such are tourism, culture and religion.

I think that Serb police and military forces during 1998/1999 war caused great damages to Hadum Mosque, and unfortunately, many other sacral buildings throughout Kosovo shared the fate of this Mosque.

Restoration and conservation of the mosque was very successful. I think is one of the first buildings that have been properly and professionally restored. However, this phase lacked restoration and conservation of mural painting. It is important to underline that the restoration work did not, under any circumstances, obstruct the religious rites practiced in this mosque.

The mosque meets only partially the current demands, since the number of worshippers is increasing daily, and soon there might be a need to modify the premises around the mosque. In addition, all buildings existing in the original context, such is the library and abdesane should be rebuilt, while nishanet (gravestones) should be registered and treated accordingly.

CHwB, as an implementing organization from Sweden and co-donor with Packard Foundation from the United States of America, have completed successfully the conservation process, by involving a professional team with local and international experts. I think that the organization that carried out the restoration should continue with the remaining work in the future.

## ZERA TË TJERE PËR RESTAURIMIN E XHAMISË SË HADUMIT

**OSMAN GOJANI**, *arkitekt, drejtor I IMK në Gjakovë*

Xhamia e Hadumit si objekt ka rëndësinë e saj fetare si për zejtarët e Carshisë së Madhe ashtu edhe për qytetin e Gjakovës në veçanti, Pos tjerash afërsia e saj me "xhematin" është tejet positive dhe mjaft funksionale.

Si monument kulturor kjo xhami posedon vlera të mëdha si arkitekturale poashtu edhe të artit, duke përfshirë këtu pikturat murale, e që si monument i tillë mund të kontribuoj në zhvillime në fushat e ndryshme si turizm, kultura dhe besimi.

Mendoj se shkatërrimi i këtij monumenti nga forcat policore e ushtarake serbe gjatë luftës së viteve 1998/99 solli dëm të mëdha Xhamisë së Hadumit e fatin e objektit në fjalë përjetuan edhe shumë vepra sakrale të tjera në Kosovë.

Restaurimi dhe konservimi i xhamisë është shumë i sukseshëm, mund të themi se për nga menyra është një nga objektet e para që u trajtua në mënyrë profesionale.

Natyrisht në këtë fazë mendoj se ka munguar restaurimi dhe konzervimi i pikturave murale. Është e rëndësishme të ceket se gjatë kryerjes së punëve restauruese nuk është penguar procesi I kryerjes së rritit fetar.

Xhamia tani mund të themi që i plotëson kushtet pjesërisht pasi që numri i "xhematit" dita ditës po rritët, për këtë ndoshta do të ishte e nevojshme modifikimi i hapësirave që gjenden rreth objektit të xhamisë, poashtu mendoj që të rindërtohen të gjitha objektet e gjendjes fillestare si biblioteka, abdesaneja dhe te trajtohen dhe nostrifikohen edhe "nishanet" (varrezat).

CHwB, si organizatë implementuese nga Suedia dhe bashkëdonator me Fondacionin Packard nga Shtetet e Bashkuara, ka kryer konzervimin në mënyrë të sukseshme, me ekip profesional, me ekspertet vendor edhe ndërkombëtar. Mendoj dhe njëherit dëshiroj që organizata e cila e realizoj restaurimin të vazhdoj edhe punët e mbetura në të ardhmen.

**ISMAIL KOSHI**, *retired professor of Albanian literature and language*



I do not know of any place in the world without religious buildings. So it is natural that Gjakova has many mosques, and Hadum Mosque being the oldest in Gjakova. This mosque, as a monument, is preserved thanks to the awareness of both parts of the hemisphere.

During the last war, attempts were made to destroy this building, but thanks to God's will, it survived even though only partially, as the library and mejtep (religious school), which were in good condition, were destroyed completely.

The restoration was carried out superbly, beautifully and without mistakes and now, the building is well-maintained. The restoration work did not present any obstacles for practicing of religious rites. Yet, current needs are much greater and the mosque no longer is big enough to receive all worshippers, so it is necessary to enlarge it and make some changes, as for example add the library building that was a part of the building complex, move the Islam Community Office to the Mosque of Mahmut Pasha so the mejtep would become available, and since the mosque itself cannot be enlarged, then some of the stores around it should be removed.

We do not have donations from the locals, the people are poor. We are grateful to foreign donators who have helped in restoring the mosque. Also, as far as CHwB is concerned, I am very satisfied with the work done in the mosque, because it is an important and needed place of religious and spiritual refuge for worshippers.

**AVNI KËPUSKA**, *retired lawyer*



Mosques are necessary because they gather the most conscientious people of Muslim faith.

Hadum Mosque as a monument has a great cultural and historical value not only for

**ISMAIL KOSHI**, *professor i letërsisë dhe gjuhës shqipe, pensionist*

Nuk di që ka vend në botë pa objekte fetare. Pikërisht për këtë Gjakova ka mjaft xhami, e mbi tjerat Xhamia e Hadumit është objekti më i vjetër në qytetin e Gjakovës. Kjo xhami si monument ruhet nga koshienca e dy hemisferave botërore.

Gjatë luftes së fundit u bënë përpjekje që të shkatrohet ky objekt, por deshi Zoti dhe xhamia shpëtoi, edhe pse jo tërësisht, biblioteka dhe mejtepi të cilat ishin të mbajtura mirë u shkatruan tërësisht. Restaurimi u bë me përgjegjësi të plotë, bukur dhe pa gabime dhe tani mbahet mirë. Gjatë punëve restauruese nuk ka pasur pengesa për zhvillimin e riteve fetare.

Koha po dikton se hapësira e tanishme e xhamisë nuk po mjafton, pra është e vogël, ka nevojë për zgjerim dhe për këtë mendoj se janë të nevojshme ca ndryshime, si psh të shtohet biblioteka që ishte në kompleks, zyra e Bashkësisë Islame të transferohet në Xhaminë e Mahmut Pashës në mënyrë që të lirohet hapësira e mejtepit, dhe pasi që xhamia si objekt nuk ka mundësi zgjerimi të hiqen disa dyqane rreth tij.

Donacione nga vendorët nuk kemi, populli është i varfër. Çdo respekt për donatorët e huaj që ndihmuan në restaurimin e xhamisë. Po ashtu sa i përket CHwB-së jamë tepër i kënaqur me punët e bëra në xhami, pasi që si objekt fetar e shpirtëror është shumë i domosdoshëm për besimtarët.

**AVNI KËPUSKA**, *jurist i diplomuar, pensionist*

Xhamia është objekt i domosdoshëm sepse i mbledhë njerëzit më të ndërgjegjshëm të besimit islam.

Hadum Xhamia si monument ka vlerë kulturo-historike shumë të madhe jo vetëm për gjakovarët, por edhe më gjërë për e tërë popullin shqiptar.



people of Gjakova, but also for all Albanians. Destruction of the mosque was a tragic event during the Albanian-Serbian war of 1999. It was tragic both in the cultural and religious aspect. Personally, I am satisfied with the restoration, but I think that some additional work has to be done in the building and around it.

I like this mosque because it is the very core of the Carshia e Madhe of Gjakova. It is surrounded by many various craft shops. This characteristic was particularly appreciated by many foreign chroniclers such as the Turkish chronicler Evlia Çelebi, who spoke very highly of the lead-covered dome. I also think that the mosque should not be surrounded by residential buildings, because it should stand out from its surrounding. This could be achieved with a fencing wall that would be built with respect to the environment of the mosque, respectively of the building complex.

The conservation works did not obstruct at all the practice of religious rites.

In my opinion, a fountain should be added to the complex of Hadum Mosque, and also light fixtures should be installed, as this is of a great importance for me and the monument itself.

There is no doubt that gravestones should be treated too, while the original state of the complex should be reinstated by reconstructing the library and mejtep.

Besides worshipers, who gain the most from restoration of this mosque, Gjakova itself benefits because of special importance of this monument for this town.

It is very grand and humane from the foreign donors to allocate means for restoration of this important building. As far as CHwB and its work are concerned, we are very satisfied and we expect that they will continue with the remaining work in the future.

Shkatërimi i xhamis ishte një dëm tragjik që u bë gjatë luftës shqiptare-serbe të vitit 1999. Tragjike ishte si në aspektin e vlerës kulturo-historike po ashtu edhe fetare.

Personalisht jam i kënaqur me restaurimin e xhamis, por mendoj që duhet të përfundohet edhe me disa punë të tjera si në objekt ashtu edhe në mjedisin rreth tij.

Me pëlqen se kjo xhami është në bërthamën e Çarshisë së Madhe të Gjakovës. Rreth saj kemi plotë dyçane me lloje të ndryshme të zejeve. Kjo është pëlqyer nga shumë kronist të huaj e posaqërisht nga udhëpërshkruesi turk Evlia Çelebi ku pos tjerash flet për mbulesën e plumbit të xhamisë. Njëherit mendoj se xhamia nuk duhet të jetë e rrethuar me objekte banimi meqë ajo duhet të veçohet. Të veçohet dhe të përkufizohet edhe me një mur rrethues, mur që do t'i përgjigjet mjedisit të objektit, përkatësisht kompleksit.

Punët gjatë konservimit të xhamisë aspak nuk penguan në kryerjen e ritit fetar.

Sipas mendimit tim, kompleksit të Xhamisë së Hadumit duhet shtuar Fontanën si dhe të zgjidhet çështja e ndriçimit e që për mua ka rol dhe rëndësi për monumentin.

Medoemos duhen të merren masa për trajtimin e varrezave si dhe t'i këthehet gjendja fillestare e kompleksit duke rindërtuar bibliotekën dhe mejtepin.

Dobi më të madhe nga restaurimi ka "xhemati" por edhe Gjakova sepse kjo xhami është pos tjerash edhe monument me rëndësi të veçantë për qytetin. Është madhështi, humanitet nga ana e donatorëve të huaj që ndan mjete për restaurimin e objektit. Sa i përket CHwB dhe punëve që i ka realizuar, jemi shumë të kënaqur dhe njëherit presim që, pasi kemi fituar besim që t'i vazhdojnë punët edhe në të ardhmën.

**ROBERT GJONI**, *hotel host*

It is good to have these monuments, regardless of the religion they belong to.

Hadum Mosque, aside religious value, also is of national importance.

During the last war, the mosque was destroyed, the minaret was ruined... This monument was miserable before the restoration.

Now it looks much better, because its dignity is restored and it is returned to its previous state. I like everything about it. The work is done beautifully and the splendor is even more apparent from the vicinity.

Even though I am not a member of this religious community (I am catholic), I think that the restoration work did not obstruct the religious rites. I would like that all the work is completed, i.e. the work that has remained unfinished, such are the murals, interior decoration and the gravestones. Since it is a building complex, it should be treated as whole. The work that has been done in this monument should be completed appropriately. As I said previously, I am not a Muslim, but I think that the mosque now meets the requirements for practicing religious rites.

We will benefit greatly from many local and international visitors, since this is a building worth visiting.

I hold in very high esteem both the donators and CHWB, and I would like to thank them for their contribution.

**BURBUQE NELREXHEPI**, *student AAB, Art Academy*

Hadum Mosque is valuable for the Muslim community in Gjakova and the rest of Kosovo.

This monument has not only religious, but also other values that increase the importance of the Mosque itself and the town of Gjakova.



**ROBERT GJONI**, *hotelier*

Është mire të kemi këso monumente pa marr parasysht përkatësin fetare të tyre.

Xhamia e Hadumit pos vlerës fetare ka edhe rëndësi kombëtare.

Gjatë luftes së fundit ishte e shkatërruar, minarja e përgjysmuar dhe si objekt i vjetër, monument me vlera të larta dukej e mjerueshme para restaurimit. Tani duket mirë, sepse u kthye në gjendje të maparshme, iu kthy dinjiteti që më parë e gëzonte. Çdo gjë më pëlqen. Bukur është punuar, si nga largë ashtu edhe nga afërsia duket shkëlqyeshëm. Edhe pse nuk i takoj këtij komuniteti fetar (jam pjestar i fesë katolike), mendoj se punët restauruese nuk kanë penguar në kryerjen e ceromonive fetare. Kisha pasur dëshirë që punët të kryhen në tërësi, pra ato punë që kanë mbetur si për gjysëm. Fjala është për muralet, dekorimet në enterier si dhe varrezat në eksterier, në mjedisin e kompleksit të xhamisë.

Si kompleks vlenë të trajtohet në tërësi. Një punë që fillon duhet edhe të përfundon si i ka hije monumentit.

Sikur cekta edhe më parë, nuk i takoj komunitetit islam, por mendoj se xhamia tani për tani i plotëson kushtet për kryerjen e riteve fetare.

Kemi dobi të shumfishtë si nga vizitorët vendor ashtu edhe nga ata të huaj meqë është një objekt kulti që ia vlen të vizitohet.

Për donatorët si dhe për CHWB në veçanti kamë mendim tejet të mire dhe iu falenderohem në kontributin e dhënë deri më tani.

**BURBUQE NELREXHEPI**, *studente AAB, Akademia e Arteve*

Xhamia e Hadumit si objekt fetar e ka vlerën e vet për komunitetin islam në Gjakovë, por edhe më gjërë.

Ky objekti si monument flet se pos vlerës fetare ka edhe vlera të tjera që ia risin rëndësin e Xhamisë së



I think that before its destruction, the mosque was a part of a complex consisted of more buildings: it had a hajat (porch) annex, as well as a library, which no longer exist.

The main aim of restoration was to salvage the mosque, since it was damaged heavily after the war. The building was restored professionally and now it looks very good.

I never heard anyone complain that the restoration work obstructed the religious rites, yet I think it is appropriate to stop the works while the religious ceremonies are underway.

The Hadum Mosque Complex is important and of great interest not only for Gjakova, but for the whole of Kosovo too, because it is one of the places that has preserved the old characteristics and it is worth visiting.

I think the mosque meets the needs for religious practices, yet I think that worshipers are the ones to give a more accurate answer.

We will greatly benefit from this building in its religious aspect, but we will also gain from it as a monument with cultural, historic and artistic values.

I thank the foreign donors for their contribution, but I think we should also have investments from the relevant local institutions. The work on the mosque was carried out quite impressively and I wish every success in the future to the restoration team.

**ESAT REXHA**, Secretary of the Council of Islam Community in Gjakova

Hadum Mosque is more than just a religious building; it represents one of the foundations of town of Gjakova and, as such, it represents many great social and cultural values, making it a unique building in Kosovo.



Hadumit por edhe vetë qytetit të Gjakovës.

Mendoj se para shkatërimit xhamia ishte një kompleks më ma tepër objekte përcjellëse, pra kishte edhe një hajat të shtuar, biblioteken të cilat tani nuk i kemi.

Qëllimi kryesor i restaurimit ishte të shpëtoi xhamia, pasi ishte dëmtuar rëndë gjatë luftës. Objekti u restaurua në mënyrë profesionale dhe është bërë mirë.

Nuk kam pasur asnjë informatë se gjatë kryerjes së punëve është pënguar zhvillimi i riteve fetare, por prap mendoj se është mirë që gjatë kohës së ceremonive të mos punohet.

Kompleksi i Xhamisë së Hadumit paraqet një kompleks më interes jo vetëm për qytetin e Gjakovës, por edhe për Kosovën, si një nga vendet që deri më tani ka ruajtur tiparet e vjetra dhe ia vlenë të vizitohet.

Mendoj se xhamia i plotëson kushtet për kryerjen e ceremonive, por për këtë me se miri është të pytet xhemati që e frekuenton më së shumti këtë objekt. Kemi dobi të shumëfishtë si objekt fetar, por edhe si monument kulturo-historik e artistik.

Pos donatorëve të huaj, të cilëve iu falenderohemi për kontributin e dhënë, është mirë të kemi investime edhe nga institucionet përkatëse vendore. Puna është kryer mjaft mirë nga ana e implementuesve të punimeve dhe u deshiroj suksese edhe në punë të tjera restauruese.

**ESAT REXHA**, sekretar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjakovë

Xhamia e Hadumit është më shumë se ndërtim fetar, ajo paraqet gurë themelin e parë të qytetit të Gjakovës dhe si e tillë ngërthen më vehte vlera shumë të larta shoqërore dhe kulturore, prandaj mund të thuhet se është unikat në gjithë trevat e Kosovës.

Ky objekt më parë ishte i mbyllur me "çardak" e që

This building was initially enclosed with a cardak (porch), which was destroyed together with the minaret and other auxiliary buildings during the war. For this reason, I think the complex of Hadum Mosque has lost some of its original beauty.

Nonetheless, the restoration carried out after the war, has brought back the brilliance of the building and reinstated its values. Restoration was the most appropriate measure to be undertaken and all the work was done properly, however we are concerned about the prospect of restoring the gravestones - nishans, the library building, the fountain - shadervan, as well as completion of works on mural decorations in hajat - porch and inside the mosque.

We are very grateful to donators and the implementers. We thank them for all the help provided to restore Hadum Mosque back to its values and introducing the potential to use this building not only by worshipers, but also as a tourist attraction in Gjakova.

gjatë luftës së fundit së bashku me minaren dhe objektet tjera përcjellëse u shkatërua. Për këtë arsye mendoj që kompleksi I xhamisë ka humbur në bukuri, mirëpo me restaurimin e bërë pas luftës mendoj se ky objekt ka dalë në dritë dhe se I janë kthyer vlerat që më parë I gëzonte. Restaurimi si proces ishte shumë I qëlluar dhe të gjitha punët e kryera janë me vend, por shprehim shqetësimin në pamundësinë e rrëgullimit të varrezave (nishaneve), objektit të bibliotekës, shadërvanit si dhe në kryerjen e punëve të dekorimeve muraleve si në hajat ashtu edhe brenda xhamisë.

Kemi konsideratë të lartë për donatorët dhe punëkryesit. I falenderojmë në ndihmën e dhënë që Xhamisë së Hadumit ti kthehën vlerat dhe potenciali që si objekt të shfrytëzohet jo vetëm për besimtarët por edhe për qëllime turistike fitimprurëse në qytetin e Gjakovës.

## AFTERWORD

Regarding the exterior restoration and conservation works 2003-2005

### Results

The project for restoration of the exterior of Hadum Mosque is completed and we in CHwB, being responsible for the project, are satisfied with the results.

The capacity building of the local professionals has been successful. Nine local stone conservators from the Institute for the Protection of Monuments (IPM) Prishtina, IPM Gjakova and Museum of Kosovo have been trained as a part of the project. Now, Kosovo has local craftsmen that are good at lead-roof covering and detailed stonework. Local materials have been identified, processed and used. An international and local network of experts and professionals for future activities has been created. Local professionals (heritage officers, architects, conservators and craftsmen) have been educated in restoration theory through seminars and workshops. In close connection to the restoration works, the first eleven maintenance programs for Kosovo monuments ever have been developed, including the one for Hadum Mosque. A painting conservation study has been produced. Good relations with the proud Islamic Society, as the owners and users of the Mosque, have been established. The community now has an increased awareness regarding the importance of preserving a Living Monument.

### Next steps to take

With the new lead roof, the interior will hopefully be secured for a long time. But as the interior plaster and paintings suffered a lot from the leaking roof after the 1999 attack, a careful interior restoration and conservation is greatly needed. CHwB has done a project description and applied for funding from United States through UNESCO.

The heritage sector of Kosovo is not yet fully capable of taking care of its most valuable monuments, due to limited resources (experts, management structure, financial means, international networking, etc.). Therefore there is still a great need for support from the International Community. A continuing capacity building approach towards the

## PASTHËNIA

*Rreth restaurimit të eksterierit dhe punëve konservuese në 2003-2005*

### Rezultatet

Projekti i restaurimit të eksterierit të xhamisë është përfunduar dhe ne në CHwB, si palë përgjegjëse për projektin, jemi të kënaqur me rezultatin.

Ndërtimi i kapaciteteve të profesionistët vendorë ka qenë i suksesshëm. Dhjetë konservatorë vendorë të gurit nga Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve (IMM) të Prishtinës, IMM të Gjakovës dhe Muzeu i Kosovës janë trajnuar. Kosova tani ka mjeshtër vendorë të aftë për punimin e mbulesave kulmore nga plumbi dhe gdhendjen e detajeve në gurë.

Materialet vendore janë identifikuar, përpunuar dhe përdorur. Poashtu, është krijuar një rrjet i ekspertëve dhe profesionistëve vendorë e ndërkombëtarë për aktivitete të ardhshme. Profesionistët vendorë (zyrtarë të trashëgimisë, arkitektë, konservatorë dhe mjeshtër) kanë zgjeruar dijen rreth teorisë së restaurimit nëpërmes seminareve dhe punëtorive. Krahas punëve restauruese, janë punuar njëmbëdhjetë programet e para për mirëmbajtjen e monumenteve të përzgjedhura në Kosovë, duke përfshirë edhe një për Xhaminë. Në anën tjetër, është punuar një studimi për konservimin e muraleve, ndërsa është vendosur një lidhje e mirë me Bashkësinë Islame, e cila është pronare dhe shfrytëzuese e objektit. Komuniteti tani është më i vetëdijshëm për rëndësinë e ruajtjes së një Monumenti të Gjallë.

### Hapat e ardhshëm

Falë kulmit të ri nga plumbi, shpresojmë se enterieri i xhamisë do të jetë i mbrojtur edhe për një kohë të gjatë. Sidoqoftë, pasi që suvaja e brendshme dhe muralet janë dëmtuar nga rrjedhja e kulmit pas sulmit të vitit 1999, nevojitet të bëhet një restaurim dhe konservimi i kujdesshëm. CHwB ka zhvilluar një përshkrim të këtij projekti të mundshëm dhe ka aplikuar për fonde nga Shtetet e Bashkuara nëpërmes UNESCO-s.

Spektori i trashëgimisë në Kosovë nuk është ende plotësisht i aftë për t'u përkujdesur për monumentet e saja më të çmuara, për shkak të resurseve të kufizuara (ekspertët, struktura menaxhuese, mjetet



local professionals will lead to a more sustainable preservation of the valuable - and vulnerable - monuments in the future.

There is also a need to continue with strengthening the awareness inside the local Islamic Community regarding the importance of proper caretaking of the Mosque. It is also imperative to educate the users in caretaking and to engage heritage professionals in the regular observation of the monument and see to that the professional and the users are communicating in a positive way.

**Dick Sandberg**

*Architect*

*Architect, Senior Heritage Advisor and former International Project Manager for CHwB in Kosovo*

**Further information**

Please visit CHwB Website:  
[kosovo@chwb.org](mailto:kosovo@chwb.org)

financiare, rrjetëzimi ndërkombëtar, etj). Qasja e vazhdueshme ndaj ndërtimit të kapaciteteve të profesionistëve vendorë do të shpie drejt ruajtjes më të qëndrueshme të monumenteve të vlefshme dhe të rrezikuara.

Në anën tjetër, ekziston një nevojë e madhe për ngritjen e vetëdijesimit brenda komunitetit vendor islam rreth rëndësisë së përkujdesjes për xhaminë dhe edukimit të shfrytëzuesve rreth kësaj përkujdesje. Gjithashtu, nevojitet angazhimi i një profesionisti të trashëgimisë në vëzhgimin e vazhdueshëm të monumentit, duke siguruar se profesionistët dhe shfrytëzuesit komunikojnë në mënyrë pozitive.

**Dick Sandberg**

*Arkitekt, Këshilltar i Lartë për Trashëgimi dhe ish Menaxher Ndërkombëtar i Projekteve për CHwB-në në Kosovë*

**Për informata të tjera**

Ju lutemi vizitoni ueb-faqen e CHwB-së:  
[www.chwb.org/kosovo](http://www.chwb.org/kosovo)

## List of References for “Context of Hadum Mosque in Ottoman/Balkan Architecture”

1. **ARIK, R.** - “Batılılaşma Donemi Türk Mimarisi Örneklerinden Anadolu’da Uc Ahsap Cami”, Ankara Üniversitesi Basımevi 1973
2. **AYVERDI, E.H.** - “Avrupa’da Osmanlı Mimari Eserleri: Yugoslavya, Vol.III, Book 3”, İstanbul 1981, pp.313;314
3. **CHOULIA, S.** - “Das Herrenhaus des Georgios Schwarz in Ambelakia”, Kulturministerium, Athens 2003
4. **KUBAN, D.** - “Sinan’s Art and Selimiye”, İstanbul 1997
5. **KUBAN, D.** - “Hayat House”, İstanbul
6. **KURAN, A.** - “İlk Devir Osmanlı Mimarisinde Cami”, METU Faculty of Architecture , Ankara 1964
7. **NECIPOGLU, Gulru**, “The Age of Sinan. Architectural Culture in the Ottoman Empire”, Princeton University Press, 2005
8. **REDZIC, H.** - “Cinq monuments sous coupole Ottomans dans la region de Kosovo et Metohija”, Starina Kosova, Vol.I, pp.93-101
9. **SEZGIN, H.** - "Cultural Heritage of the Ottomans in the Balkans", pp. 357-364

## Lista e referencave për “Konteksti i xhamisë së Hadumit në arkitekturën osmane dhe të Ballkanit”

1. **ARIK, R.** - “Batılılaşma Donemi Türk Mimarisi Örneklerinden Anadolu’da Uc Ahsap Cami”, Ankara Üniversitesi Basımevi 1973
2. **AYVERDI, E.H.** - “Avrupa’da Osmanlı Mimari Eserleri: Yugoslavya, Vol.III, Book 3”, İstanbul 1981, pp.313;314
3. **CHOULIA, S.** - “Das Herrenhaus des Georgios Schwarz in Ambelakia”, Kulturministerium, Athens 2003
4. **KUBAN, D.** - “Sinan’s Art and Selimiye”, İstanbul 1997
5. **KUBAN, D.** - “Hayat House”, İstanbul
6. **KURAN, A.** - “İlk Devir Osmanlı Mimarisinde Cami”, METU Faculty of Architecture , Ankara 1964
7. **NECIPOGLU, Gulru**, “The Age of Sinan. Architectural Culture in the Ottoman Empire”, Princeton University Press, 2005
8. **REDZIC, H.** - “Cinq monuments sous coupole Ottomans dans la region de Kosovo et Metohija”, Starina Kosova, Vol.I, pp.93-101
9. **SEZGIN, H.** - "Cultural Heritage of the Ottomans in the Balkans", pp. 357-364

**Editor:** Andrew Herscher

**Contributors:**

Prof. Dr. Zeynep Ahunbay  
Dr. Fejaz Draqolli  
Dick Sandberg

**The CHwB Project 2004 - 2005 and The Implementation Phase** written by Dick Sandberg, Sezair Gafurri, Lindita Cervadiku and Nol Binakaj

**Pictures:**

**Destruction of Market Street in Gjakova** taken by Dr. Fejaz Draqolli;  
All pictures in **“Context of Hadum Mosque in Ottoman/Balkan Architecture”** taken by Prof. Dr. Zeynep Ahunbay;  
**All other pictures** in the publication taken by CHwB;

**Translation:**

Jeta Limani

**Graphic design:**

Jeta Limani and Nol Binakaj

**Redaktor:** Andrew Herscher

**Bashkëpunëtorët:**

Prof. Dr. Zeynep Ahunbay  
Dr. Fejaz Draqolli  
Dick Sandberg

**Projekti i CHwB-së gjatë 2004 - 2005 dhe Faza e Implementimit** u shkruan nga Dick Sandberg, Sezair Gafurri, Lindita Cervadiku dhe Nol Binakaj

**Fotografitë:**

**Shkatërrimi i Çarshisë së Madhe në Gjakovë** nga Dr. Fejaz Draqolli;  
Të gjitha fotografitë në **“Konteksti i chamisë së Hadumit në arkitekturën osmane dhe të Ballkanit”** nga Prof. Dr. Zeynep Ahunbay;  
**Të gjitha fotografitë tjera** në publikim nga CHwB-ja;

**Përkthimi:**

Jeta Limani

**Dizajni grafik:**

Jeta Limani dhe Nol Binakaj

726.2:72.025(496.51)

Trashëgimia pas luftës: Restaurimi i Xhamisë së Hadumit - Heritage after War:  
The Restoration of the Hadum Mosque / [Andrew Herscher...et al.]. - Prishtinë:  
Cultural Heritage without Borders, 2007. - 98 f. ; 23 cm.

Teksti krahasues në gjuhën shqipe dhe angleze

1. Herscher, Andrew

2. Limani, Jeta

**ISBN 978-9951-8741-0-6**